EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5654
E shtunë, 15 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Aleatët kërkojnë fokusim në dialog

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS KA VOTUAR TRI PROJEKTLIGJET QË NDRYSHOJNË MANDATIN DHE DETYRAT E MINISTRISË DHE TË FSK-së

USHTRIA U BË



Me 107 vota për deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të premten tri projektligjet bazë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK): Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës që i japin kësaj force mandat të ri ushtarak. Ky votim për ushtrinë u cilësua historik nga përfaqësuesit politikë të Kosovës, por edhe nga ambasadori amerikan Philip Kosnett. FSK-ja, e cila do të vazhdojë me emrin e njëjtë, pritet t'i ketë 5 000 trupa aktivë dhe 3 000 rezervë

AKTUALE

USHTARËT E RAMUSHIT, PARAMILITARËT E VUÇIQIT SI DHE KINEZËT DHE RUSËT E VOJVODA SHESHELIT! F. 12



Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

KRIJIMI I USHTRISË SË KOSOVËS, VLERË E SHTUAR PËR PAQEN DHE SIGURINË NË KOSOVË DHE RAJON F. 11



Prof. Lisen BASHKURTI

RËNIA HEROIKE E MUJËS DHE 40 BASHKËLUFTËTARËVE TË TIJ, HUMBJE E MADHE PËR UÇK-në F. 7



EKONOMI

POLITIKAT QEVERITARE TË PUNËSIMIT NUK NDIKOJNË SA DUHET NË KRIJIMIN E VENDEVE TË REJA TË PUNËS F. 9

ASK-ja: PËR TRE MUAJ QEVERIA SHPENZOI 474.5 MILIONË EURO F. 9

KULTURË

VEPRIMTARIA ATDHETARE E SHKRIMTARIT SYLEJMAN KRASNIQIT F. 8

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Veseli takon kongresistin Eliot Engel



PRISHTINË, 13 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në përmbyllje të vizitës zyrtare në ShBA ka takuar kongresistin amerikan Eliot Engel, i cili i ka dhënë përkrahje të parezervë për ecjen përpara të shtetit të Kosovës, për transformimin e FSK-së në Ushtri dhe reformat në ekonomi e sundim të ligjit.

"Me mikun e madh të Kosovës, kongresistin Eliot Engel. Ai edhe një herë më shprehu përkrahjen e parezervë për ecjen përpara të shtetit të Kosovës, për transformimin e FSK-së në Ushtri dhe reformat në ekonomi e sundim të ligjit", ka shkruar Veseli në faqen e tij në Facebook.

Studentët ftojnë popullin të protestojë para Kryeministrisë

Studentët vijojnë të mbeten në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" e prej aty kanë treguar sinjale se nuk do të tërhiqen nga kauza e tyre, pasi afati ka skaduar për Ramën dhe ata i kanë bërë thirrje nëpër medie gjithë popullit që sot (e shtunë) t'i bashkohet në një protestë mbarëkombëtare



TIRANË, 14 DHJETOR - Dialogu është ai që mban larg protestuesit dhe kryeministrin Edi Rama, me këtë të fundit, që edhe pse shpreh pajtimin për tetë kërkesat e studentëve, nuk i është përgjigjur ultimatumit të tyre për thirrjen e një seance të jashtëzakonshme plenare të Kuvendit në orën 16:00.

Studentët vijojnë të mbeten në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" e prej aty kanë treguar këtë pasdite sinjale se nuk do të tërhiqen nga kauza e tyre pasi afati ka skaduar për Ramën dhe ata i kanë bërë thirrje nëpër medie gjithë popullit që sot (e shtunë) t'i bashkohet në një protestë mbarëkombëtare. "Kemi bërë thirrje për një protestë kombëtare, sepse minutat që i dhamë Ramës mbaruan. Tani i bëjmë thirrje gjithë popullit që t'i bashkohet protestës tonë në mënyrë masive", u shpreh një nga studentët.

Ndërkohë studentëve që janë vendosur poshtë zyrës së kryeministrit pritet t'u bashkohen një grup të rinjsh nga Miloti që janë nisur në këmbë pavarësisht shiut dhe aktualisht kanë arritur në Kamëz. Në protestën e sotme (e shtunë) të studentëve pritet të ketë zëra nga të gjitha grupet e interesit, pasi ata nuk përjashtojnë që t'u bashkohen minatorët apo banorët e "Astirit", pasi sipas tyre mjafton që qytetarët të kenë flamurin kombëtar dhe jo logot e partive. "Për sa kohë i bashkohen kauzës sonë janë të mirëpritur. Ne nuk po luftojmë vetëm për veten, por për gjithë shqiptarët që janë shtypur nga ky sistem. Në radhë të parë u kërkoj ndjesë banorëve të Astirit, se ata që i ndaluan ishin persona të caktuara, me qëllime të caktuara, dhe krijuan kakofoni. U bëjmë thirrje të gjithë banorëve të na bashkohen, simboli i vetëm është flamuri kuq e zi. Në momentin se do të vijnë me flamurin shqiptar, do i mirëpresim. Ne kërkojmë mbështetje për këto kërkesa që kemi, ne nuk përjashtojmë asnjë, jemi këtu në orën 10 dhe po vuajmë", u shpreh një student.

Sipas zërave nga protesta, të shtunën në shesh do të jenë përkrah studentëve edhe dhjetëra intelektualë për t'i mbështetur. Edhe ish-zëvendësministri i Arsimit Taulant Muka nxiti studentët të vijojnë protestën, duke i këshilluar që të pranojnë intelektualët. "I sollët një shpresë qytetarëve. Pse i tremben vettingut në akademi. Pranoni mes jush dhe intelektualë që të tregojnë si bëhet zgjidhja. Unë isha në Ministrinë e Arsimit, aty ka këshilltarë me plagjiaturë dhe pa diploma. Një nga ata këshilltarë që ju quajti ngelës mezi mbaroi shkollën 12 vjet në Itali dhe mori doktoraturën. Fund presionit është koha t'u japim zë intelektualëve dhe studentëve", u shpreh Muka përpara turmës.

Ndërkohë në frontin përballë tyre, kryeministri Rama duket i vendosur për të mos lëshuar pe. Mbetet të shihet sesi do të vijojë kjo përplasje studentë-Kryeministri, në një kohë kur edhe Buxheti 2019 është rikthyer në Kuvend, pas refuzimit nga presidenti Ilir Meta.

Banorët e 'Unazës së Re' u bashkohen studentëve

Banorët e 'Unazës së Re' vijuan edhe të premten me protestën e tyre kundër projektit që prek rreth 316 shtëpi. Një prej tyre, zbuloi se do t'i bashkohen protestës së studentëve, pas apelit të tyre për protestë mbarëkombëtare. "E duam Shqipërinë pa Edi Ramën, sepse ai është një kriminel, hajdut dhe mashtrues. Jemi me studentët, studentët janë bijtë tanë. Të shtunën në orën 9 të gjithë bashkuar, të gjithë të bashkuar jemi të fituar", tha banori gjatë protestës, duke zbuluar se do t'i bashkohen kauzës së studenteve.

"Thirrja e banorëve të Unazës së re dhe qytetarëve është që të shtunën t'i bashkohen studentët, sepse kauzat shkrihen në një. Tashmë nuk është më kauzë e Unazës së Re, por e gjithë Shqipërisë. Ju e shikoni si i denigron studentët nga mëngjesi deri në darkë. Kauzat janë bashkuar në një, dhe ne do të kemi vetëm parullën "Rama ik", tha njëri nga banorët.

Mogherini i fton në takim liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor

BRUKSEL, 14 DHJETOR - Shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, do të organizojë një takim joformal me liderët e Ballkanit Perëndimor gjatë javës së ardhshme në Bruksel.

Në takimin e 19 dhjetorit, do të diskutohet për situatën në rajon, arritjet gjatë vitit 2018 si dhe planet për vitin e ardhshëm, ka njoftuar Shërbimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian.

"Në vitin 2018 është konfirmuar perspektiva e qartë evropiane, e bazuar në meritat dhe rezultatet, për të gjithë partnerët në Ballkanin Perëndimor", thuhet në njoftim.

Komisioni Evropian, në shkurt, miratoi strategjinë për Ballkanin Perëndimor, ndërkaq në samitin me BE-në në Sofje, në muajin maj, u mblodhën gjithë përfaqësuesit e vendeve të Ballkanit Perëndimor, për herë të parë pas 15 vjetëve.

Në takimin e 19 dhjetorit do të marrë pjesë edhe Komisioneri për Zgjerim i BE-së, Johannes Hahn.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Pas ushtrisë kërkohet që t'i jepet prioritet dialogut Kosovë - Serbi

Aleatët kërkojnë fokusim në dialog



Pas formimit të ushtrisë së Kosovës, partnerët kryesorë të Republikës së Kosovës kanë kërkuar fokusim te dialogu për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania dhe BE-ja kanë vlerësuar se, pas zhvillimeve të fundit, të dy shtetet duhet t'i kthehen dialogut të Brukselit, duke shtuar se Kosova dhe Serbia duhet t'i normalizojnë raportet. Mirëpo analistët politikë kanë bërë me dije se kërkesat e palëve në këtë proces do të radikalizohen

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Aleatët kryesorë të Kosovës i kanë ftuar liderët institucionalë që pas transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri të fokusohen në procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, ka kërkuar nga Kosova të bëjë përpjekje për normalizimin e marrëdhënieve me fqinjin e saj, Serbinë, për t'i zbutur tensionet dhe për të krijuar kushte për përparim të shpejtë në dialog. Ai ka thënë se ceremonia e transformimit të FSK-së duhet të jetë rast për reflektim solemn dhe ripërkushtim për paqe, stabilitet e prosperitet për Kosovën dhe fqinjët e saj. "Tani është koha për të gjithë liderët dhe faktorët ta fokusojnë energjinë në dialog", ka deklaruar ambasadori Kosnett.

Në ditën e miratimit të transformimit të FSK-së, BE-ja, e cila nuk është pajtuar me këtë proces, ka kërkuar nga institucionet e Kosovës t'i përmbushin obligimet që dalin nga ky proces. "Kuvendi i Kosovës ka miratuar sot një pako të ligjeve rreth Forcës së Sigurisë së Kosovës. Sikurse NATO-ja, Bashkimi Evropian vazhdon ta ndajë mendimin që mandati i FSK-së duhet të ndryshohet nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës dhe gradual i cili është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Bashkimi Evropian pret që Kosova të vazhdojë t'i përmbushë obligimet sipas marrëveshjes së parë të arritur në Bruksel në prill të vitit 2013 si dhe marrëveshjen e sigurisë", është thënë në një komunikatë të BE-së.

Edhe Gjermania ka bërë thirrje për vetëpërmbajtje pas vendimit të Kuvendit për transformimin e FSK-së në ushtri dhe tensioneve të fundit rreth taksës për mallrat serbe. Zëdhënësi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Rainer Breul, ka theksuar se ky rast nuk duhet të shërbejë si pretekst për eksalimin e situatës. "Kosova dhe Serbia duhet t'i normalizojnë raportet mes dy vendeve. Aprovimi i këtyre ligjeve nuk duhet të shërbejë si pretekst i eskalimit të situatës", është shprehur Breul.

Por analistët politikë mendojnë se vazhdimi i këtij procesi nuk do të jetë i lehtë pas formimit të ushtrisë. Njohësi i proceseve politike, Belul Beqaj, ka thënë për "Epokën e re" se kërkesat e palëve do të radikalizohën. "Procesi do të radikalizohet, madje edhe kërkesat e palëve. Mendoj se kjo nuk duhet të jetë arsye për ndarje, por për zgjidhje të problemit brenda kufijve", ka thënë Beqaj.

Raportet mes palëve janë tensione pas një sjellje destruktive të Serbisë ndaj Kosovës në arenën ndërkombëtare e cila kulmoj me mospranimin e Kosovës në Interpol. Pas këtyre veprimeve, Qeveria e Kosovës mori vendim të vendosë taksë prej 100 përqindësh për mallrat serbe që hyjnë në Kosovë.

Edhe pas disa përpjekjeve pozita dhe opozita ende nuk kanë arritur ta gjejnë një kompromis rreth dialogut me Serbinë. Së fundi, Partia Socialdemokrate (PSD) ka dorëzuar në Kuvend një projektrezolutë dhe një projektligj për dialogun me Serbinë. Deri më tani këto dokumente kanë marrë përkrahjen e dy partive të koalicionit qeverisës, AAK-së dhe Nismës, por jo edhe të PDK-së, e cila ende nuk ka ndonjë qëndrim zyrtar ndaj përpjekjes së PSD-së.

Ndërkaq opozita, LDK-ja dhe LV-ja, e kanë kundërshtuar iniciativën e PSD-së. Një ditë më parë, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka takuar ambasadorët e vendeve të Quintit të cilëve ua ka paraqitur draftin e parë të marrëveshjes gjithëpërfshirëse, ligjërisht obliguese ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Ai ka treguar se ky draftdokument është dokument mbështetës për procesin ekzistues të dialogut si dhe aspektet që ndërlidhen me përshpejtimin e këtij procesi. "Shefi i dialogut teknik, Avni Arifi, ka prezantuar kapitujt që për ne do të përbëjnë parametrat kryesorë të marrëveshjes, e cila do t'i hapë rrugë normalizimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Draftdokumenti me anekset përcjellëse u është dorëzuar edhe të gjithë bartësve të institucioneve dhe kryetarëve të të gjitha subjekteve politike. Në ditët dhe javët në vijim ky draftdokument do të diskutohet me të gjitha palët në shoqërinë tonë, për të arritur te dokumenti përfundimtar, ku do të përfshihet ekspertiza e të gjithëve", ka thënë kryeministri Haradinaj pas takimit.

Në Universitetin "Ukshin Hoti" u mbajt ligjëratë për Skënderbeun

PRIZREN, 14 DHJETOR (ER) - Në Universitetin Publik "Ukshin Hoti" në Prizren të premten është mbajtur ligjërata "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu identiteti historik shqiptar". Ligjërata është mbajtur në kuadër të shënimit të Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut, ndërsa para të pranishmëve, në amfiteatrin e Fakultetit Ekonomik, studiuesi prof. dr. Bedri Muhadri ka folur për epokën e Skënderbeut, shtetin dhe kontributin e tij në njohjen e popullit shqiptar gjatë mesjetës, parë edhe në kontekstin e sotëm. Në këtë kontekst, historiani Muhadri e ka vlerësuar lart rolin e kryetrimit të shqiptarëve. Derisa profesor Muhadri ka folur për kontekstin historik, prof. dr. Sabahajdin Cena ka mbajtur një ligjëratë rreth figurës së Skënderbeut në krijimtarinë gojore shqiptare. Në akademi morën pjesë dhe e mbështetën anëtarët e Këshillit Drejtues, profesorët, studentët dhe qytetarët.



Kuvendi i Republikës së Kosovës ka votuar tri projektligjet që ndryshojnë mandatin dhe detyrat e Ministrisë dhe FSK-së

USHTRIA U

Me 107 vota për, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të premten tri projektligjet bazë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK): Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës që i japin kësaj force mandat të ri ushtarak. Ky votim për ushtrinë u cilësua historik nga përfaqësuesit politikë të Kosovës, por edhe nga ambasadori amerikan Philip Kosnett. FSK-ja, e cila do të vazhdojë me emrin e njëjtë, pritet të ketë 5 000 trupa aktivë dhe 3 000 rezervë



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, pas votimit në lexim të dytë, të premten kanë miratuar me shumicë absolute të votave tri projektligjet bazë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK): Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës që i japin kësaj force mandat të ri ushtarak. Në seancën plenare për ushtrinë nuk kanë marrë pjesë deputetët e grupit parlamentar të Listës Serbe. Në seancën solemne të mbajtur në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilën e kryesoi kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ishin të pranishëm edhe presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj, ministri Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, si dhe kadetë dhe oficerë të tjerë të FSK-së. Arsyetimin e raporteve me rekomandime për të tre projektligjet e ka paraqitur kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës, Haxhi Shala, i cili i ka ftuar deputetët t'i votojnë projektligjet së bashku me amendamente.

Në një atmosferë festive, me 105 vota për, Kuvendi miratoi Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes së bashku me 11 amendamente, Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës me 45 amendamente dhe me 107 vota, si dhe miratoi Projektligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me gjithsej 45 amendamente dhe me 107 vota për. Me aprovimin dhe pas hyrjes në fuqi të këtyre ligjeve, FSK-ja merr mision ushtarak, kurse Kosova rrumbullakoi fazën e shtetndërtimit me institucionin më të rëndësishëm siç është Ushtria.

Votimi është përcjellë me duartrokitje të gjata në Kuvend.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se me këtë votim po fillon një epokë e re për shtetin e Kosovës. Ai ka tërhequr vërejtjen se në pjesën për mysafirë në Kuvend ishin të pranishëm edhe disa kadetë të FSK-së që po e prisnin këtë vendim. "Nga ky moment, zyrtarisht e kemi Ushtrinë e Kosovës. Në sallë kemi kadetët e Forcës së Sigurisë së Kosovës që nga ky çast janë ushtarë të Kosovës, të cilëve ua urojmë ushtrinë e Kosovës", ka thënë Veseli.

Vendimi për formimin e ushtrisë së Kosovës është përcjell me një atmosferë festive në Prishtinë.

Sheshet e kryeqytetit janë mbushur me flamuj të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Britanisë së Madhe, të Gjermanisë, të Francës, të Italisë dhe të shteteve të tjera të cilat Kosova i konsideron si vende që e kanë ndihmuar në vazhdimësi atë.

Forca e Sigurisë se Kosovës javën e kaluar është pajisur me 24 automjete ushtarake të tipit "Humvee", të cilat kanë ardhur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Forca e Sigurisë së Kosovës, e cila do të vazhdojë me emrin e njëjtë, pritet t'i ketë 5 000 trupa aktivë dhe 3 000 rezervë, të armatosur lehtë.

Për dallim nga NATO-ja, e cila ka në përbërje të vet shumë shtete, Qeveria amerikane nëpërmjet ambasadorit të saj në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se votimi për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës është historik për Kosovën. Kosnett, po ashtu, ka thënë se siguria e një vendi varet nga cilësia e marrëdhënieve të sigurisë që ka. "Teksa Kuvendi vepron sot, le të rikujtojmë se siguria e një vendi varet nga cilësia e marrëdhënieve të tij të sigurisë dhe marrëdhëniet paqësore dhe bashkëpunimi të dobishme me fqinjët e saj, por edhe nga forca dhe profesionalizmi i forcave të saj të armatosura", ka thënë Kosnett.

Liderët në Prishtinë, Tiranë dhe Shkup urojnë për formimin e ushtrisë së Kosovës

Pasi Kuvendi ka miratuar transformimin e FSK-së në ushtri, liderët institucionalë dhe partiakë kanë uruar popullin e Kosovës për këtë ngjarje historike. Ata kanë theksuar se ushtria e Kosovës do të jetë gjithmonë shumetnike dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve.

Presidenti i Kosovës dhe komandanti suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Hashim Thaçi, ka thënë se ushtria është nderi, siguria dhe mirëqenia e Republikës së Kosovës. "Pas dy dekadash shumë të mundimshme, më në fund po e përmbyllim procesin e shtetndërtimit. Në Kuvendin e Kosovës, me shumicë absolute, përtej dallimeve

BË





përgjegjshëm dhe dimë të qëndrojmë të bashkuar për t'i mbrojtur interesat e popullit dhe shtetit tonë. Krijimi i ushtrisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes është dhurata më e mirë për festat e sivjetme të fundvitit", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka deklaruar se ushtria e Kosovës do të jetë në funksion të paqes me të gjitha ushtritë e rajonit. "Ky është një lajm i jashtëzakonshëm për konsolidimin e shtetit të Kosovës. Forca e Kosovës do të jetë gjithmonë shumetnike dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj, në funksion të paqes me të gjitha ushtritë e rajonit, përfshirë edhe ushtrinë e Serbisë që të kemi partneritet për paqe", ka thënë Haradinaj.

Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka vlerësuar se përpjekjet historike për shtet të konsoliduar dhe sovran po kurorëzohen me formimin e ushtrisë. "Ushtria e Kosovës buron nga populli liridashës e paqedashës i Kosovës dhe iu përket të gjithë qytetarëve të saj, pa dallim. Ajo do të jetë garantuese e paqes dhe stabilitetit në rajon, me synimin për të qenë pjesë e NATO-s dhe t'u kontribuojë qëllimeve madhore të kësaj aleance kudo në botë", ka shkruar Pacolli në profilin e vet në "Facebook".

Edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj është shprehur i bindur se Kosova do t'i kontribuojë forcimit të paqes në rajon dhe do të jetë në krah të partnerëve ndërkombëtarë dhe synimi tani është anëtarësimi në NATO. "Në këtë ditë të madhe për popullin shqiptar ne kujtojmë gjithë ata burra e gra të cilët kanë bërë të mundur lirinë e Kosovës. Kujtojmë me krenari dhe nder të gjithë ata burra e gra që kanë bërë të mundur një ëndërr shekullore të shqiptarëve për ta pasur në realitet ushtrinë", ka shkruar Limaj.

Qytetarët e Kosovës i kanë uruar edhe liderët e partive opozitare. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se themelimi i ushtrisë ishte nevojë dhe e drejtë e shtetit. "Lidhja Demokratike e Kosovës, si parti më e madhe në vend, qoftë në pozitë apo në opozitë, ka përkrahur në vazhdimësi ngritjen dhe aftësimin e FSK-së për t'u shndërruar në Forcë të Armatosur, përkatësisht në ushtri të Kosovës, në interes të mbrojtjes së vendit, pra në interes të çdo qytetari të saj", ka shkruar Mustafa.

Kurse lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka thënë se miratimi i tri ligjeve për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri është hap shumë i rëndësishëm për shtetndërtimin e Kosovës së pavarur. "Tri ligjet e reja sot janë hap shumë i rëndësishëm për shtetndërtimin e Kosovës së pavarur. Së pari, Kosova u bë me Ministri të Mbrojtjes. Së dyti, FSK u avancua drejt bërjes së saj ushtri e Kosovës, Forcë e Armatosur e Republikës së Kosovës. Amendamenti 7 e shtoi fjalën 'sovranitet', ndërsa amendamenti 42 e hoqi kufizimin për numrin e pjesëtarëve të FSK-së. Urime të gjithëve!", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Kosova ka marrë urime dhe nga lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti. "Sa shumë sakrificë, sa shumë ëndrra, sa shumë përpjekje, sa shumë martirizim ndër shekuj për të ardhur deri te këto ditë të lirisë, pavarësisë, të ushtrisë, të barazisë dhe të perspektivës. Ushtria e Kosovës është edhe një themel i paqes dhe stabilitetit të gjithë rajonit tonë me perspektivë euroatlantike", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka shkruar se vendimi historik i krijimit të Forcave të Armatosura të Kosovës dëshmon qartë se Kosova është e aftë të marrë përgjegjësi të reja për ndërtimin e institucioneve demokratike. "Vendimi historik i krijimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës dëshmon qartë se Kosova është e aftë të marrë përgjegjësi të reja për ndërtimin e institucioneve demokratike dhe për të kontribuar vendosmërisht për paqen, stabilitetin e rajonit dhe fqinjësinë e mirë. Fryma euroatlantike qëndron në themel të këtij ndryshimi historik", shkruar Meta në profilin e tij në "Facebook".

Derisa kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka zgjedhur ta postojë në rrjetet sociale një fotografi të presidentit Hashim Thaçi me uniformë ushtarake për ta uruar Kosovën për këtë ditë.

politike, si rrallëherë të zgjedhurit e popullit miratuan pakon ligjore për themelimin e ushtrisë së Kosovës. Si shoqëri dhe shtet kemi dëshmuar se jemi të guximshëm, të





Rënia heroike e Mujës dhe 40 bashkëluftëtarëve të tij, humbje e madhe për UÇK-anë

Me rastin e shënimit të 20-vjetorit të rënies heroike të komandant Mujë Krasniqit-"Kapuçit" dhe 40 bashkëluftëtarëve të tij, u tha se komandant "Kapuçi" është një ndër më meritorët për ditën e sotme, bashkë me mijëra dëshmorë të tjerë të lirisë, bashkë me komandantin legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharin



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 DHJETOR - "Në fillim të këtij muaji, kur duhej të merrnim vendim për datën e seancës në të cilën do t'i miratonim ligjet e themelimit të ushtrisë së Kosovës, nuk kisha asnjë dilemë se cila datë duhej të zgjidhej. Kjo datë do të ishte 14 dhjetori. Kjo datë është data e rënies së njërit prej komandantëve më emblematikë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, heroit të Kosovës, Mujë Krasniqit dhe 40 bashkëluftëtarëve tanë", kështu ka thënë të premten kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, me rastin e shënimit të 20-vjetorit të rënies heroike të komandant Mujë Krasniqit dhe 40 bashkëluftëtarëve të tij. Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeparlamentari Veseli ka thënë se komandant "Kapuçi" është një ndër më meritorët për ditën e sotme, bashkë me mijëra dëshmorë të tjerë të lirisë, bashkë me komandantin legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharin. "Ne sot, në këtë ditë, qëndrojmë ballëhapur para kujtimit të tyre. Ne sot ndiejmë krenari të dyfishtë. Jemi krenarë që ishim bashkëluftëtarë të tyre. Jemi krenarë që amanetin e tyre sot e plotësuam duke themeluar ushtrinë e Kosovës, duke e bërë më të fortë shtetin e Kosovës dhe më të sigurt të ardhmen e fëmijëve tanë", ka thënë Veseli.

Kreu i Kuvendit ka shtuar se sot, në këtë ditë historike, nuk mungojnë vetëm dëshmorët, por edhe luftëtarët e gjallë, që duhej të ishin në vendin e nderit. Ai ka thënë se sot mungon një prej më meritorëve për këtë ditë: Komandanti i UÇK-së, i TMK-së dhe FSK-së, Sylejman Selimi, i cili, sipas tij, hyn në radhët e atyre komandantëve të cilët kthehen të fundit nga betejat.

Veseli ka thënë se Sylejman Selimi do të kthehet fitimtar ngaqë Kosova dhe ushtria e saj kanë nevojë për të. "Ndërsa brezat që do të vijnë kanë nevojë për kujtimin e Mujë Krasniqit dhe të gjithë të rënëve për liri, për të mësuar se si jetohet e luftohet për atdheun. I përjetshëm do të jetë kujtimi për Mujë Krasniqin dhe dëshmorët e kombit, ashtu siç do të jetë e përjetshme vepra e tyre më e madhe: Liria e Kosovës", ka thënë kryeparlamentari Veseli.

Ndërkaq presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se në ditën e votimit të ushtrisë së Kosovës, pikërisht sot kur të gjithë ndihemi krenarë me djemtë dhe vajzat e uniformuara, kujtojmë rënien heroike të komandantit Mujë Krasniqit, një prej luftëtarëve më të hershëm të UÇK-së. "Themelimi i Ushtrisë së Kosovës në 20-vjetorin e rënies së Mujës dhe 40 luftëtarëve të tij është mënyra më e mirë për ta ruajtur dhe nderuar kujtimin për të gjithë heronjtë dhe dëshmorët e UÇK-së. Lavdi të gjithë të rënëve për lirinë dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka përkujtuar Mujë Krasniqin në 20-vjetorin e rënies. Limaj ka thënë se përvjetori i Mujës dhe 40 bashkëluftëtareve të tij këtë vit është më i veçantë. "Rënia heroike e Mujës dhe 40 bashkëluftëtarëve të lirisë në kufirin mes Kosovës dhe Shqipërisë ishte humbje e madhe për UÇK-në. Mujë Krasniqi ishte shembull më i mirë i një luftëtari të zotë dhe një prej celulave të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Përvjetori i Mujës dhe 40 bashkëluftëtarëve të tij këtë vit është më i veçantë. Pikërisht në këtë ditë do të realizohet një nga amanetet e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtarë të Kosovës që ishte: Ushtria e Kosovës", ka thënë Limaj.



Edita Tahiri: S'mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm në botë pa përfshirjen e plotë të grave

PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) - Ish-ministrja për Dialog dhe kryetarja e Lobit Rajonal të Grave të Evropës Juglindore (RWLSEE), Edita Tahiri, po qëndron në Argjentinë, ku po merr pjesë në konferencën ndërkombëtare të ministreve të vendeve të Amerikës Latine dhe Karaibeve që mbahet në Buenos Aires, me temën për fuqizimin e grave dhe ndërlidhjen me zhvillimin e qëndrueshëm të botës. Pjesëmarrës në këtë konferencë janë gratë lidere, ministre dhe përfaqësuese të shoqërisë civile nga të gjitha vendet e këtij rajoni. Konferenca kryesohet nga ministrja e Argjentinës, Carolina Stanley, dhe ministrja e Urugait, Mariella Mazzoti.

Fokusi qendror i kësaj konference ndërkombëtare është prezantimi i ideve dhe rekomandimeve për sesionin e 63-të të Komisionit për Statusin e Grave që pritet të mbahet në mars të vitit 2019, në selinë e OKB-së në Nju Jork. Gjatë tri ditëve të punës intensive është shfaqur një potencial i mendimeve të grave për atë se si synimet botërore për zhvillim të qëndrueshëm nuk mund të realizohen pa një përfshirje të plotë të grave në të gjitha rrjedhat progresive dhe pa një barazi të plotë gjinore.

Kryetarja e Lobit Rajonal, Edita Tahiri, është pjesë e delegacionit që përfaqëson Evropën dhe Azinë Qendrore në këtë konferencë ndërkombëtare, të nominuara nga UNWomen për rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore. Në një deklaratë dhënë gazetës



"Epoka e re", Edita Tahiri ka theksuar se pjesëmarrja e saj në këtë konferencë krijoi mundësi për këmbimin e përvojave nga të dyja anët e brigjeve të Atlantikut dhe ishte një rast i mirë për t'i njoftuar me rolin historik që gratë e Kosovës luajtën në proceset e çlirimit dhe pavarësimit të Kosovës, si dhe për proceset e shtetndërtimit dhe paqendërtimit. Ajo foli për misionin dhe rezultatet e Lobit Rajonal të Grave të Evropës Juglindore si organizatë rajonale e grave lidere nga politika dhe shoqëria civile nga shtatë vendet e Ballkanit perëndimor, duke thënë se Lobi ka bashkuar gratë që besojnë te fuqia e grave për ta ndërtuar paqen, zhvillimin dhe integrimet euroatlantike për të gjitha shtetet e Ballkanit perëndimor. "Puna jonë tash 12 vjet, e mbështetur nga UNWomen, ka dhënë rezultate mjaft të mëdha dhe ne po dëshmojmë se sa më shumë gra që angazhohen dhe fuqizohen aq më shumë paqe dhe prosperitet do të kemi në botë", ka thënë ajo.

Në kuadër të punimeve të kësaj konference, Edita Tahiri ka zhvilluar një varg takimesh me pjesëmarrëset e konferencës, ku ka veçuar takimin me lideren e shquar argjentinase, dr. Mabel Bianco, e cila udhëheq rrjetin rajonal të organizatave joqeveritare të Amerikës Latine dhe Karaibeve si dhe ministren argjentinase për çështjet e grave, Fabiana Tunez, me të cilat Tahiri ka biseduar për shtimin e bashkëpunimit rreth qëllimeve të përbashkëta për fuqizimin e rolit të grave për një ardhmëri më të mirë në botë. "Mendoj se nuk mund të ketë një zhvillim të qëndrueshëm në botë pa përfshirjen e plotë të grave. Gratë janë një kapital strategjik, janë gjysma e popullatës dhe janë të gatshme dhe të dijshme të kontribuojnë për ta transformuar botën drejt progresit dhe paqes", ka thënë ish-ministrja Edita Tahiri.

Pasditen e së premtes është mbajtur ceremonia shtetërore për transformimin e Forcës së Sigurisë në ushtri të Kosovës

Liderët shtetërorë: Ushtria e Kosovës do t'i shërbejë paqes dhe stabilitetit në rajon

Ushtria e Republikës së Kosovës do t'u shërbejë të gjithëve pa dallim dhe do të bëhet faktor i sigurisë dhe stabilitetit në vend, rajon dhe më gjerë. Kështu kanë deklaruar të premten liderët shtetërorë, presidenti Thaçi, kryeparlamentari Veseli dhe kryeministri Haradinaj, në ceremoninë shtetërore për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri. Pavarësisht prej vërejtjeve, ata janë zotuar se FSK-ja do t'i zhvillojë kapacitetet në bashkëpunim të plotë me NATO-n dhe partnerët e tjerë



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Miratimi i pakos ligjore për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri nga Kuvendi i Kosovës mëngjesin e së premtes është pasuar edhe me mbajtjen e një ceremonie shtetërore të organizuar nga Ministria e FSK-së, ku të pranishëm kanë qenë përfaqësues të institucioneve, partive politike, shoqatave të luftës, familjes së dëshmorëve, por jo edhe ambasadorët e huaj të akredituar në vendin tonë. Me këtë rast, presidenti i vendit, njëherësh Komandanti Suprem i FSK-së, Hashim Thaçi, ka thënë se formimi i ushtrisë është një hap i rëndësishëm drejt përmbylljes së shtetësisë. "E gëzofshim ushtrinë e Kosovës ne dhe gjeneratat që do të vijnë! Nderimet më të thella për çdo dëshmor që ka dhënë jetën që ne të gëzojmë edhe këtë ditë historike. Përmbyllëm një proces të nisur para shumë vjetësh. Morëm një hap të rëndësishëm drejt përmbylljes së shtetësisë sonë pasi ushtria është shtyllë e shtetit. Kjo është meritë, para së gjithash, e çdo pjesëtari të FSK-së, e punës dhe profesionalizimit të tyre. Falë kësaj pune është bërë e mundur që të ecim përpara për zgjerimin e mandatit të FSK-së që të bëhet ushtri e vërtetë e Kosovës. Gjatë karrierës sime kam mbajtur poste të ndryshme dhe kam kryer detyra të ndryshme. Por, ndër ato që më jep më së shumti nder dhe kënaqësi është të jem Komandant Suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës", është shprehur Thaçi, duke shtuar se ushtria e Kosovës do t'u shërbejë të gjithëve pa dallim dhe do të bëhet faktor i sigurisë dhe stabilitetit. "I falënderojmë edhe partnerët tanë ndërkombëtar, ShBA-në dhe të gjitha vendet e NATO-s. Ata i sigurojmë se FSK-ja do të mbetet forcë shumetnike që do t'i shërbejë çdo qytetari të Kosovës pa dallim feje e etnie dhe do të bëhet faktor i sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Partnerëve tanë ndërkombëtarë u themi se mënyra më e mirë për ta shprehur mirënjohjen tonë është duke e kthyer vendin tonë në një eksportues të paqes dhe sigurisë. FSK-ja është edhe një mënyrë tjetër e jona për t'i thënë faleminderit bashkësisë ndërkombëtare për përkrahjen që na kanë dhënë gjithmonë. Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës do të bëhet në bashkëpunim dhe në koordinim me NATO-n dhe partnerët tanë në botë, të cilët dëshirojnë të ketë paqe të qëndrueshme në Kosovë dhe në rajonin tonë", ka deklaruar Thaçi. Sipas presidentit Thaçi, të premten të gjitha partitë politike pa dallim treguan se kur është në pyetje interesi i vendit i tejkalojnë interesat e ngushta partiake dhe votojnë për Kosovën. "Kërkoj që këtë unitet të treguar sot ta ruajmë edhe për proceset e tjera të rëndësishme që na presin në muajt në vijim. Të bashkuar do të jemi më të fuqishëm dhe do të marrim vendime më të guximshme për Kosovën dhe për të ardhmen tonë", ka theksuar presidenti Thaçi.

Veseli: Shtetit iu shtua një ditëlindje e madhe, ajo e ushtrisë së Kosovës

Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se 14 dhjetori do të kujtohet me krenari nga brezat që do të vijnë. Ai ka thënë se datave të rëndësishme shtetërore po i shtohen edhe ditëlindja e ushtrisë së Kosovës. "Secili prej nesh do ta ketë një kujtim për këtë ditë. Ditëlindjeve të mëdha të shtetit tonë sot po i shtohet edhe një ditëlindje e madhe, ajo e ushtrisë së Republikës së Kosovës", ka deklaruar Veseli. Ai ka thënë se Kosova ka qenë dhe vazhdon të jetë në anën e drejtë të historisë dhe e ardhmja e saj është e sigurt në strukturat euroatlantike. "Ne jemi pjesëtarë të një kombi që në gjithë historinë kurrë nuk sulmoi askënd, kurrë nuk zuri vend urrejtja ndaj të tjerëve, nuk ushqyem ideologji në dëm të të tjerëve, edhe pse ishim viktima të ideologjive. Ne besojmë te drejtësia sepse ne kemi luftuar vetëm për drejtësi. Ne kemi qenë dhe jemi në anën e drejtë të historisë. Edhe e ardhmja jonë është e sigurt, integrimi në strukturat euroatlantike", është shprehur Veseli, duke shtuar se Kosova përherë u është mirënjohëse Shteteve të Bashkuara të Amerikës për ndihmën e pakursyer që ka dhënë në të gjitha fazat e lirisë dhe pavarësisë. Veseli ka thënë se uniforma e ushtrisë së Kosovës do të jetë uniformë nderi për të gjitha komunitetet në Kosovë. "Ushtria e Kosovës do të jetë vazhdim i traditës humane që na bën krenarë para vetes dhe para botës. Një ushtri për veten dhe për botën", ka thënë Veseli.



Haradinaj: Ushtria e Kosovës është ushtri e paqes


Edhe kryeministri i shtetit të Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova po hyn si e fundit në rreshtin e ushtrive të botës. Në këtë rresht ai ka theksuar se Kosova po hyn në paqe dhe e ka për nder të jetë pas Amerikës. "Rreshti është fjala e parë që e mëson kur bëhesh ushtar. Rreshti për ne ka qenë i mohuar. Që mijëra vjet të tjerët kanë bërë rresht. Ne jemi bërë rresht në krejt ushtritë e botës, po na është mohuar e drejta me qenë në rreshtin tonë. E populli, ndër më të vjetrit në Evropë, i fundit po bëhet me rresht. Ne po vijmë në paqe, po vijmë të fundit në rresht, por po hyjmë me paqe. Paqen e kemi fituar me dhimbje. E kemi fituar me aleatët tanë. Paqes i prinë Amerika. E kemi për nder të rreshtohemi pas Amerikës", ka thënë Haradinaj.

Ai ka vlerësuar se nuk ka mik më të mirë, por as armik më të keq se FSK-ja, duke e cituar kështu gjeneralin amerikan James Mattis, tani sekretar i Mbrojtjes në ShBA."Po e citoj një thënie të gjeneralit Mattis: S'ka mik më të mirë se marinsi, por s'ka edhe armik më të keq. Edhe unë them se s'ka mik më të mirë se FSK-ja, por edhe armik më të keq. Sot janë gëzuar edhe të vdekurit, edhe të gjallët! Edhe ushtarët e Ibrahim Rugovës, edhe të Adem Jasharit", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri ka vlerësuar se ushtria e Kosovës asnjëherë s'do të kthehet kundër popullit të vet, pa marrë parasysh etninë e tyre, duke shtuar se serbët do të mbrohen nga ushtria si në jug, po ashtu edhe në veri të Kosovës. "S'do të veprojmë që ushtria jonë të kthehet kundër popullit të vet, jo kundër serbëve, si në jug e në veri, ata janë të këtij vendi. Ne s'kemi ardhur te rreshti si të fundit për të rrezikuar të tjerët, por për ta forcuar paqen. I ftojmë të gjitha ushtritë të bëjmë partneritet për paqen, po filloj me Shqipërinë, e pastaj Malin e Zi, Maqedoninë e, pse jo, edhe ushtrinë e Serbisë siç dëshirojmë edhe paqen me Serbinë. Po ndalem me këtë të fundit. Zoti e bekoftë ushtrinë e Kosovës!", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Ahmeti nxjerr urdhëresë për ndalimin e përdorimit të mjeteve piroteknike

PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, në bazë të kompetencave të tij, ka lëshuar të premten urdhëresën për ndalimin e përdorimit të mjeteve piroteknike në vendet e hapura publike, përkatësisht në tregje, rrugë dhe sheshe. Sipas njoftimit të Komunës së Prishtinës, kjo urdhëresë vlen për periudhën 30 dhjetor 2018 deri më 3 janar 2019. "Kushdo që vepron në kundërshtim me këtë urdhëresë do të gjobitet 100 euro. Për zbatim të urdhëresës kujdeset Drejtoria e Inspeksionit", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.





Përkujtohen dëshmorët Astrit Bytyqi, Hysni Kajtazi dhe Besim Qarri

FERIZAJ, 14 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu me bashkëpunëtorë, babanë e dëshmorit të kombit, Astrit Bytyqi, Gafurrin, përfaqësues të organizatave të luftës, familjarë të dëshmorëve dhe qytetarë, kanë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve të kombit në këtë komunë në përkujtim të rënies heroike të dëshmorëve Astrit Bytyqi, Hysni Kajtazi dhe Besim Qarri. Me këtë rast, kryetari Aliu ka thënë se përkujtimi i dëshmorëve në këtë ditë ka një simbolikë të veçantë për shkak të themelimit të ushtrisë së Kosovës. "Ne sot jemi përulur para tre dëshmorëve të Ferizajt, të cilët ranë heroikisht në betejën e Gorozhubit, në zonën e Pashtrikut së bashku me komandant Mujë Krasniqi-'Kapuçin' dhe shumë veteranë të asaj kohe", ka thënë ai, duke u lutur të rrojë gjithmonë ushtria e Kosovës. "E paçim përgjithmonë Ushtrinë e Kosovës! E paçim përgjithmonë shtetin e Kosovës! Lavdi gjithë heronjve e dëshmorëve të kombit! Lavdi gjithë të rënëve në të gjitha periudhat e sakrificës së gjatë të popullit shqiptar!", ka thënë Aliu.

Ndërsa Gafurr Bytyqi, kryetar i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, ka thënë se është krenar me të birin e tij dëshmor dhe me bashkëluftëtarët e tij.



Komuna e Gjilanit me donatorë e bëjnë me shtëpi familjen Korça

GJILAN, 14 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, së bashku me donatorin Avni Haziri, pronar i "OrangeNet", kanë bërë inaugurimin e shtëpisë së re për familjen e Rrahim Korçës, e cila ka shtatë anëtarë të familjes. "Përurimi i shtëpisë bashkon familjen e ndarë për shkak të kushteve të rënda ekonomike dhe sociale. Është shumë vështirë që bashkëshortët me dy fëmijë të jetojnë së bashku, kurse tre të tjerë të ndarë për shkak të mungesës së kulmit mbi kokë. Kjo është një ditë e veçantë për këtë familje dhe për të gjithë ne së bashku", ka thënë Haziri. Ai ka falënderuar donatorët në krye me Avni Hazirin nga "OrangeNet" dhe të gjithë ata që kanë kontribuar që sot kjo shtëpi të strehojë edhe një familje me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale.

Donatori Avni Haziri, pronar i "OrangeNet", ka falënderuar për bashkëpunim kryetarin Haziri dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tij që e kanë ndihmuar deri në përfundimin e kësaj shtëpie.

Begaj thotë se është i kënaqur me bashkëpunimin me KFOR-in

MALISHEVË, 14 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur të premten në një takim komandantin e ri të njësive të LMT të KFOR-it për regjionin e jugut, Cengiz Bahadir Ozgur, si dhe komandantin aktual të KFOR-it për regjionin e jugut, Cen Sinan Barim, me të cilët ka biseduar për bashkëpunimin e mirë ndërmjet KFOR-it dhe Komunës së Malishevës.

Kryetari Begaj, pasi i ka uruar mirëseardhje komandanti të ri, është zotuar se bashkëpunimi me KFOR-in do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ai ka falënderuar KFOR-in për bashkëpunimin e deritanishëm dhe për sigurinë që ofron për vendin tonë. Edhe zyrtarët e lartë të KFOR-it për regjionin e jugut e kanë falënderuar kryetarin Begaj për bashkëpunimin që kanë si dy institucione.



KEDS-i: Kemi siguruar energji të nevojshme

Prishtinë, 14 dhjetor (ER) - Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim të Energjisë Elektrike (KEDS) ka njoftuar se ka siguruar energjinë e nevojshme nga importi për të pasur furnizim të pandërprerë për gjithë vendin në ditët e ardhshme. Sipas njoftimit të KEDS-it, rrjeti i vjetër i shpërndarjes mund të shkaktojë ndërprerje të paplanifikuara megjithatë, sipas tyre, kanë marrë të gjitha masat parandaluese për të siguruar ndërhyrje të menjëhershme në këto raste, duke shtuar edhe numrin e ekipeve për ndërhyrje. "Ne inkurajojmë konsumatorët tanë që të na kontaktojnë menjëherë në rastet e ndërprerjeve për shkak të prishjeve në rrjet. Edhe një herë, energjia e siguruar nga importi do të sigurojë 24/7 furnizim për gjithë vendin. Po ashtu, nëse ka ndërprerje teknike, ne do të njoftojmë përmes rrjetit social 'Facebook', duke informuar se ka pasur prishje teknike dhe se kemi dërguar ekipe për ta rregulluar atë", është bërë me dije në njoftimin e KEDS-it.



Politikat qeveritare të punësimit nuk ndikojnë sa duhet në krijimin e vendeve të reja të punës



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Raporti i auditimit të performancës "Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave qeveritare të punësimit" nxjerr në pah se politikat e punësimit në nivel qeveritar dhe sektorial nuk janë efikase dhe efektive. Vonesat për miratimin e dokumenteve strategjike, mosdefinimi i qartë i përgjegjësive të institucioneve si dhe mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare për zbatimin e aktiviteteve që ndërlidhen me punësim, tregon se politikat e punësimit në nivel të Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që janë pjesë e këtij auditimi nuk i janë nënshtruar një planifikimi adekuat. Këto mangësi rrezikojnë realizimin e suksesshëm të objektivave dhe aktiviteteve që ndërlidhen me punësim.

Në raportin e auditimit theksohet se vonesat e mëdha për funksionalizimin e Agjencisë së Punësimit kanë vështirësuar zbatimin e masave aktive të tregut të punës, nuk kanë ofruar mundësi të barabarta për një numër të konsiderueshëm të papunëve si dhe kanë pamundësuar identifikimin e të papunëve që kanë probabilitet më të lartë për t'u bërë të papunë afatgjatë. Ndërsa tek Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë mangësitë që kanë vështirësuar vlerësimin e efektiv të zbatimit të masave të cilat kanë kriter punësimin janë vonesat për integrimin e të dhënave si dhe mungesa e të dhënave të plota për krijimin e vendeve të reja të punës

Raporti thekson se mangësitë e evidentuara te të dy agjencitë, për monitorimin që u bëhet masave gjatë zbatimit, iu kanë vështirësuar përfituesve njohjen e përvojës së punës, kufizuar mundësitë e tyre për punësim në të ardhmen, nuk kanë legjitimuar punësimin si dhe kanë ndikuar në paraqitjen e statistikave joreale të shkallës së papunësisë në vend. "Monitorimi i efektivitetit të politikës së punësimit nuk ka rezultuar efikas dhe i suksesshëm si në nivel qeveritar, po ashtu edhe në atë sektorial. Mangësitë në monitorimin aktual të kryer nga Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë e audituara pamundësojnë që këto institucione apo edhe qytetarët të kenë një pasqyrë të qartë të ndikimit të politikës së punësimit. Ndërkaq, fakti që të dy agjencitë e audituara ende nuk kanë kryer monitorimin e efektivitetit të masave, e pamundëson një vlerësim real të shkallës së realizimit të masave si dhe ndikimit që ato kanë për gjenerimin dhe mbajtjen e vendeve të reja të punës", është bërë me dije në raportin e auditimit të performancës "Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave qeveritare të punësimit". Lidhur me këtë raport ka folur Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani. "Shkalla e papunësisë në vend është alarmante, prandaj politikat në nivel qeveritar dhe sektorial duhet të shërbejnë si përgjigje ndaj gjendjes së krijuar të papunësisë në vend. Kjo mund të arrihet përmes një planifikimi adekuat të kapaciteteve të nevojshme njerëzore dhe financiare për implementim të politikës si dhe përmes krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm monitorues", ka thënë Osmani.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë rekomandimet e veta të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se autoritetet përgjegjëse, respektivisht Zyra e Kryeministrit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Punësimit dhe Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë t'i shtojnë përpjekjet e tyre për aë përmirësuar planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e politikës së punësimit.

ASK-ja: Për tre muaj Qeveria shpenzoi 474.5 milionë euro

PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar llogaritë qeveritare të Kosovës në bazë tremujore. Ky publikim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe (TM3 2018).

Shuma e përgjithshme e të hyrave të Qeverisë për TM3 2018 ishte 635.9 milionë euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte të cilat paraqesin 62 për qind të totalit të të hyrave, ndërsa pjesa e mbetur e të hyrave është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave. Në TM3 2018 totali i përgjithshëm i shpenzimeve të Qeverisë ishte 474.5 milionë euro.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë: kompensimi i punëtorëve (31 për qind), kontributet sociale dhe përfitimet (25 për qind), formimi i kapitalit bruto (22 për qind) dhe konsumi i ndërmjetëm (9 për qind). Pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në struktura të tjera të shpenzimeve.



Krijimi i ushtrisë së Kosovës, vlerë e shtuar për paqen e sigurinë në Kosovë dhe rajon



Prof. Lisen BASHKURTI

Pas një rruge të gjatë diskursi politik në nivele lokale, rajonale dhe ndërkombëtare, Republika e Kosovës krijoi ushtrinë e vet. Ky është një hap shumë i rëndësishëm në procesin shtetformues të Republikës së Kosovës si dhe një element themelor i sigurisë së pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Me këtë akt Republika e Kosovës ka plotësuar kuadrin e institucioneve themelore shtetërore të saj.

E krijuar mbi bazat e parimeve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ushtria e saj e ka të përcaktuar misionin e vet. Ushtria e Kosovës ka karakter thellësisht mbrojtës nga qëllimi, objektivat strategjike, struktura ushtarake, kapacitetet njerëzore dhe logjistike. Ushtria e Kosovës do të ndërtohet mbi parime thellësisht demokratike dhe me përbërje shumetnike, që reflekton karakterin shumetnik të shoqërisë dhe të institucioneve demokratike të saj.

Ushtria e Republikës së Kosovës do të ndërtohet qysh në themelet e saj mbi parimet politike, demokratike dhe strategjike të NATO-s, për arsye se ushtria e Kosovës është krijuar me synimin madhor që t'i bashkohet Aleancës së Atlantikut të Veriut sa më parë që të jetë e mundur.


Me këtë synim madhor për t'u bërë pjesë e NATO-s, ushtria e Kosovës do të japë kontribut të shtuar për paqen dhe sigurinë në rajon dhe do të jetë e gatshme për të marrë pjesë dhe të kontribuojë në nismat që NATO-ja ka ndërmarrë dhe do të vazhdojë të ndërmarrë në dobi të paqes dhe sigurisë në të ardhmen kudo në botë.

Ushtria e Republikës së Kosovës ka fatin të krijohet në një kohë kur Shqipëria, partnerja më strategjike e saj, është anëtare e NATO-s. Qenia e Shqipërisë në NATO do t'i ofrojë Kosovës gjithë përvojën e saj të vyer për ndërtimin dhe funksionimin e ushtrisë, për ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të institucioneve demokratike të sigurisë, për përvojën e rrugës së integrimit në Aleancën e Atlantikut të Veriut përmes PfP (Partneritetit për Paqe), MAP (Planin e Veprimit për Anëtarësim), sikundër do t'i japë mbështetjen e plotë në procesin e lobimit dhe votimit për anëtarësimin e Kosovës si anëtare me të drejta të plota në NATO.





Ushtarët e Ramushit, paramilitarët e Vuçiqit si dhe kinezët dhe rusët e Vojvoda Sheshelit!



Behxhet Sh.
SHALA-BAJGORA

Daja Stoltenberg dhe tezja Mogerini: Më në fund, pozitë dhe opozitë, sikur edhe komunitetet jashtë mercenarëve të Lista Srpska, votuan për formimin e Ushtrisë së Kosovës që fuqishëm u kundërshtua, madje nën kërcënime edhe nga shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, e që u pritë me ereksion shovinist në Serbi. Edhe shtetet e BE-së e kundërshtuan formimin e ushtrisë, ndërsa gjenerali i paramilitarëve serbë, Aleksandar Vuçiq, që bënë aq shumë krime në Kosovës, e mobilizoi ushtrinë serbe duke e zhvendosur shtabin afër kufirit me Kosovën e që në gjuhën ushtarake do të thotë se vetëm mungonte shpallja e luftës, edhe zyrtarisht. Bishtat e Vuçiqit si Vulini, Marko Gjuriq dhe Ivica Daçiq, kërkuan nga ndërkombëtarët ta pengojnë formimin e ushtrisë, duke u kërcënuar me destabilizim të situatës. Prej të gjithëve që i përmenda, realisht, rrezik më të madh paraqet Marko Gjuriq që e pati filluar luftën dhe për rezultat ishte pshurrja në brekushe dhe ndotja e mjedisit rrugëve të Prishtinës, si rezultat i heroizmit të Marko Gjuriqit. Paramilitari Aleksandar Vuçiq kërkoi nga KFOR-i ta çarmatosë Ushtrinë e Kosovës sikur ai të ishte komandant suprem i KFOR-it. Vojvoda Sheshel, me bol... të fishkura, me prostatë të zgjeruar e që nuk ia mbanë urinën sikur edhe me prapanicë të zgjeruar e që paraqet rrezik për zbrazje të pakontrolluar të zorrës së trashë, pasi e ka analizuar mirë e mirë situatën, ka kërkuar që trupat kineze dhe ato ruse të futen në Kosovë si pararojë, kurse Vojvoda Sheshel, si Cezari, të hyjë pas tyre si triumfues! Nuk është budalla Voja, ish-dashnori virtual i Karla del Pontes të cilën, për shkak të dashurisë së madhe, asnjëherë nuk e ka përmendur me emër, por e thërriste me epitete tunduese: "ona belosvetska kurva..." "ajo lavirja e përdaltë e botës...".

Në historinë botërore për gjykime të rasteve për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, Vojvoda Sheshel është i pari, deri më tani i vetmi që ofertën seksuale e përdori si argument për ndërtimin e mbrojtjes.

Po nejse, edhe Sheshelit i është lodhur e pasmja. Mua më bëri shumë përshtypje arsyetimi i Slavko Simiqit dhe të tjerëve nga Lista Serbe, ndryshe mercenarë të Vuçiqit dhe të Serbisë, që marrin shumë para nga Buxheti i Kosovës e që nuk e njohin shtetin e Kosovës e as Lartmadhërinë e Tij, Shkëlqesinë Verbëruese, presidentin e Republikës së Kosovës, zotni Hashim Thaçi, por se thonë se janë në kontakt të vazhdueshëm me presidentin e tyre, Aleksandar Vuçiq dhe Serbinë, atdheun dhe shtetin e tyre. Po këta mercenarë dhe shpërdorues të Buxhetit të Kosovës deklaruan se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për faktin se formimi i Ushtrisë së Kosovës qenka veprim kundërkushtetues. Thash, nëse u referohemi deklaratave të mëparshme, mund të kem dëgjuar gabim sepse, logjikisht, ata, si shtetas të Serbisë dhe të bindur ndaj Vuçiqit dhe Serbisë, është dashur t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese të Serbisë! Edhe te shqiptarët pati disa kundërshtime apo qëndrime vardisëse ndaj Stoltenbergut, Makronit e që nuk dallojnë fort nga Vuçiqi duke deklaruar se: "Ushtria e Kosovës nuk duhet dhe nuk mund të formohet pa pajtimin e miqve ndërkombëtarë..." apo, nëse i referohemi një Napoleoni të LV së: "FSK vetëm po e ndërron dukjen por jo edhe përmbajtjen sepse kjo as që i përngjanë ushtrisë..." . Çfarë mendimi i thellë nga doktrina e teorisë ushtarake dhe luftarake. I denjë për një mendim që mund ta thotë një idiot, më së buti ta them!!! Ushtria u bë dhe, këtu e tutje do të këndohet tjetër këngë që aspak nuk është për shije të veshit të Serbisë. Serbia e ka frikën se Ushtria e Kosovës mund (sigurisht edhe do të bëhet) anëtare e NATO-s dhe Serbia pastaj mund të këndojë këngë për Kosovën me lahutën e Filip Vishnjiqit dhe doktrinës ushtarake të Vuk Karaxhiqit.

Ramushi, Kadria dhe Hashimi: Që të tre kishin një të kaluar ushtarake, plus Hashimi, herë ushtarake e herë politike. Këtyre u ka takuar të jenë bartës të formimit të Ushtrisë së Kosovës dhe e bënë. Ramush Haradinaj nuk kishte as edhe mëdyshjen më të vogël se ushtria do të formohet sikur këtë mëdyshje nuk e kishte as Kadri Veseli. Edhe në kohën kur Stoltebergu, gjeneralët e NATO-s dhe shumë shtete të Evropës e kundërshtuan këtë ushtri, Ramushi dhe Kadria ishin edhe më të vendosur për formimin e ushtrisë. Kur Stoltenbergu na i ftohi morrat dhe kur shumica filluan të binden se është ende herët të formohet ushtria, Ramush Haradinaj në Kosovë dhe Kadri Veseli në ShBA ishin edhe më të bindur se kjo ishte çështje e mbaruar. Hashim Thaçi, si pragmatik, erudit dhe strateg që është, nuk merrej më deklarime publike, por me çështje konkrete, bënte plane ta ndërtonte një bazë të madhe ushtarake të Ushtrisë së Kosovës në Luginën e Preshevës, pasi e mbajti premtimin e dhënë më herët. Pasi filluan bombardimet e NATO-s në Kosovë në vitin 1999, u shtua dhuna e Serbisë ndaj çdo gjëje shqiptare në Kosovë. Keqtrajtime të shumta, dhunime, arrestime, vrasje dhe përzënie nga shtëpitë apo banesat e që pastaj plaçkiteshin nga ortakët e Aleksandar Vuçiqit dhe Vojvoda Sheshelit, ishin përditshmëri. Në atë kohë banoja në Lagjen Dardania në Prishtinë ku shpesh vinte Baca Adem. Edhe Ilmi Reçica banonte afër, derisa kaloi në radhët e UÇK-së. Banorët e ndërtesës dhe hyrjes ku banoja kishin frikë që shkaku se Baca Adem vinte shpesh në këtë banesë, mund ta pësonin edhe ata prandaj, në një mënyrë kishin dëshirë që të largohesha nga aty. Afër meje e kishte banesën një shok shumë i ngushtë imi dhe veprimtar i madhe dhe i guximshëm i çështjes kombëtare, Jahir Mulolli, i cili çdo ditë, përkundër rrezikut vinte të banesa ima deri në kohën kur më bindi të kalojë te ai që e kishte banesën te Saranda Tours, në bodrumet e së cilës strehoheshin tanket dhe blindat e policisë dhe ushtrisë serbe. Pas një kohe u bë një situatë e padurueshme dhe e pasigurt edhe aty dhe vendosa të kthehem në banesën time. Me të mbërri para banese hasa në një numër të madh të banorëve të lagjes që ishin organizuar, nga persona të njohur dhe që kishin ndikim e që shpëtimin e tyre e kërkonin duke u fshehur me masën pasi që paraprakisht, rrejshëm kishin përhapur lajmin se ishin vrarë nga policia serbe. Askush nuk na ndiqte përveç se ishte krijuar një frikë nga vet ne. Pasi qëndruam pak më shumë se një orë në gjendje frike, erdhi një person me kombësi rome, i vogël me trup, me një këmishë apo xhaketë ushtarake, i paarmatosur ndërsa pjesa e poshtme e uniformës përbëhej nga do tuta (trenerka) dikur me ngjyrë të kuqe e tash të papërcaktuar duke na u drejtuar me fjalët: "Shta radite ovde, marsh, piçka vam materina... "(Çka po bëni këtu, shporruni në rrotë të së ëmës...)! Po ta kishim vetëm një thua të Rexhep Malës, Fehmi Ladrovcit apo Shkëlzen Haradinaj, atë farë pisi, me një pordhë do ta shtrinim për tokë. Por, meqë kishim vendosur të iknim, kërcënimi i atij xhuxh-maxhuxhi, na erdhi si shpëtim sepse e përdorëm si alibi se: "U detyruam të iknim pasi nga shtëpitë dhe banesat na nxorën me dhunë paramilitarët serbë të armatosur deri më dhëmbë...".

Ky rast m'u kujtua kur dje, gjatë parakalimit para FSK-së, Lartmadhëria e Tij, Shkëlqesia që Vret, Presidenti i Republikës së Kosovës, zotni Hashim Thaçi, ishte i veshur sikur paramilitari që na "ndoqi" nga banesat tona në Lagjen Dardania; lart e kishte një xhaketë të FSK-së, pa kapelë në kokë, kurse poshtë dukeshin pantallonat nga kati i rrobave dhe në vend të çizmeve ushtarake, kishte mbathur këpucë elegante. Një veshje krejtësisht e papërshtatshme, e pahijshme dhe e bezdisshme për rastin e veçantë kur parakalonte para kadetëve të FSK-së, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës. Për mua ishte kombinim tipik paramilitar i veshjes aq më parë që Hashim Thaçi ka shije të rafinuar të veshjes. Me dy mendje jam nisur të shkoj në Kuvendin e Kosovës nga frika se mos Kadri Veseli, i cili gjithashtu vishet me shumë shije dhe delikatesë, në këtë seancë solemne do të vijë me pallto dhe kollare, kurse poshtë do të kishte të veshura pizhamet e natës! Kjo po tregon se diçka shumë serioze po ndodh në Kosovë!

Formimi i ushtrisë, gëzimi i përgjysmuar: Në sallën e Kuvendit ndihej një gëzim i madh, thuaja i papërshkruar. Të gjithë u gëzuan, kishte aty politikanë që kishin dalë nga UÇK-ja, komandantë të UÇK-së, tani klientë të Speciales, të ftuar specialisht për këtë ngjarje, ata që kishin ikur nga "paramilitari i armatosur, si puna ime", pasues të devotshëm dhe të sinqertë të shokut Tito, ata që u gëzuan për Cecën dhe u hidhëruan me Shakirën, kadetë të shkolluar dhe oficerë profesionistë ushtarakë, njerëz me akuza dhe me dhëmbë porcelani por, u hidhërova shumë pasi në sallë nuk e pashë kontribuuesin më të madh kombëtar, financuesin e UÇK-së në Kazakistan, diplomatin më të madh dhe më të shquar shqiptar të të gjitha kohëve i cili shpiku një veprim në diplomaci e që nuk ka arritur askush nga diplomacia botërore, raportin 8 me 2 apo, t'jua sqaroj: është fitore e madhe diplomatike kur i siguroni dy njohje, por është fitore edhe më e madhe kur i siguroni tetë çnjohje.

Po e dini se po mendoj për Behgjet Pacollin, doajenin e diplomacisë kosovare, shqiptare dhe botërore dhe bartësin e titullit më të lartë shkencor dhe akademik "Doctoris Honoris (Horroris) Causa i Universitetit John Hopnkins" në Baltimore, më falni, i Universitetit në Vlorë! Ku ka nder dhe arritje më e madhe se kur, në Ditën e Flamurit në Vlorë, për shkak të propozimit "për trajtim shkencor të çështjes shqiptare", nga shkencëtari i mirënjohur shqiptar, Behgjet Pacolli, nderoheni me Doctor Honoris (Horroris) Causa! Një mik imi që ishte afër, me të mësuar për shkakun e mungesës së disponimit tim, më ngushëlloi duke më thënë se Begja është diku afër, ndoshta, më së largu dhjetëra kilometra, pa e përcaktuar qartë lokacionin! Mendtë në kokë m'i ruajti Artistja e Merituar dhe Jashtëzakonisht e Talentuar e Popullit, Linda Morina, që me një vallëzim erotik-patriotik, më ktheu disponimin duke dridhur apo ekspozuar atë armatim që nuk e ka aktualisht FSK-ja, stringerët e përparshëm, por duke ekspozuar atë që i mungon shumicës së politikanëve kosovarë, prapanicën e shtrënguar të cilën e dridhte me një tverk, sikur disa politikanë para miqve ndërkombëtarë! Artiste e jashtëzakonshme është Linda, gjenerallejtnante e vërtetë, me një talent të shkrimit të teksteve frymëzuese, mobilizuese dhe motivuese, si Tupac Shakur dikur. Bravo Linda, e mahnitshme je! Vlen shumë më shumë se mishi i importuar nga Brazili! Nëse peshohesh me kilogram!

Cohen: Presidenti Trump e dinte që pagesat ishin të gabuara

UASHINGTON, 14 DHJETOR - Ish-avokati i presidentit Donald Trump, Michael Cohen tha se "Trumpi e dinte se ishte i gabuar urdhri që dha për të paguar në prag të zgjedhjeve dy gra me qëllimin që ato të mos flisnin rreth marrëdhënies së pretenduar me Trumpin".

Trumpi veproi sepse ishte shumë i shqetësuar se si kjo çështje do të ndikonte tek zgjedhjet, tha Cohen. Këto janë komentet e para të Cohen pas vendimit për dënimin e tij me tre vjet burgim.

Nga ana tjetër presidenti Trump ka thënë se ai nuk e ka urdhëruar kurrë Cohen që të thyejë ligjin. Por Cohen ngriti pyetjen nëse Trumpi e dinte që pagesat e bëra për Stormy Daniels dhe Karen McDougal ishin të gabuara, duke u përgjigjur: "sigurisht".

Cohen sfidoi pohimin e Trumpit se ai kurrë nuk i ka kërkuar atij që të thyejë ligjin.

"Nuk mendoj se ka ndonjë që e beson këtë", tha Cohen.

"Para së gjithash, asgjë në organizatën Trump nuk bëhej pa kaluar përmes tij. Trumpi më urdhëroi për të bërë pagesat, më urdhëroi të përfshihesha në këtë çështje", tha Cohen. "Ai e di të vërtetën sikurse unë dhe të tjerët gjithashtu e dimë të vërtetën", shtoi ai. "Amerikanët, të gjithë njerëzit kudo në botë, nuk e besojnë atë që ai thotë. Ai njeri nuk thotë të vërtetën dhe është e trishtueshme që unë duhet të marr përgjegjësinë për punët e pista të tij", tha Cohen. Por presidenti Trump mohon të ketë pasur marrëdhënie me gratë të cilat u paguan vetëm disa javë përpara zgjedhjeve.

Në një postim në "Twitter" ai u



distancua nga Cohen, duke thënë ndër të tjera se ai ishte viktimë e praktikave joligjore të ish-avokatit të tij.

BE-ja nuk do ta rinegociojë marrëveshjen për Brexitin

Vendet anëtare të BE-së kanë thënë se nuk mund të ketë ndryshime në marrëveshjen e Brexitit dhe nuk janë të hapur për rinegociim. Presidenti francez, Emmanuel Macron, ka thënë se ne nuk mund të rinegociojmë diçka që është negociuar për muaj të tërë



BRUKSEL, 14 DHJETOR - Kryeministrja britanike, Theresa May, u ka bërë thirrje liderëve evropianë t'i ndihmojnë për të siguruar në Britani përkrahje për marrëveshjen e Brexitit që ka negociuar kryeministrja britanike me Bashkimin Evropian. Mirëpo, BE-ja, në anën tjetër, ka thënë se javën tjetër do t'i prezantojë planet për Brexit pa marrëveshje.

May ka shkuar në Bruksel për të marrë pjesë në një samit të BE-së, teksa synon ta marrë mbështetjen e bllokut evropian për paktin e Brexitit, meqë nuk e ka parë këtë gatishmëri në Parlamentin britanik dhe i ka mbijetuar një vote mosbesimi gjatë kësaj jave, të organizuar nga vetë deputetët e partisë së saj. "Ekziston një shumicë në Parlamentin tim që dëshiron të ketë Brexit me marrëveshje, vetëm nëse ky pakt sigurohet në mënyrë të duhur", ka thënë May duke paralajmëruar homologët evropianë se mund të ketë pasoja nëse Britania largohet nga BE-ja pa pakt.

Mirëpo, zyrtarët e BE-së kanë thënë se nuk i kanë të qarta kërkesat e Britanisë. "Nuk e konsideroj pozitive pikëpamjen se ndoshta në Britani mendojnë që i përket BE-së të propozojë zgjidhje", ka thënë presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, në një konferencë për media të premten. "Britania po largohet, jo BE-ja. Mendoj se Qeveria britanike duhet të na tregojë se çfarë saktësisht kërkon", ka shtuar ai.

Juncker ka thënë se britanikët duhet të jenë më të qartë në sqarime brenda javësh, në rast se dëshirojnë të arrijnë përparim dhe të mënjanojnë një Brexit pa marrëveshje.

May ka thënë më parë se është në dijeni që nuk mund të arrihet mrekulli në samitin dyditor. "Nuk pres pikë kthese të menjëhershme, mirëpo shpresoj se ne do të fillojmë të punojmë sa më shpejt në kërkesat që i konsiderojmë të domosdoshme", ka thënë May.

Java në Britani ka qenë e tensionuar pasi ajo të hënën ka shtyrë seancën në Parlamentin britanik për votim të marrëveshjes së saj për Brexitin.

Zemërimi për këtë vendim ka rezultuar me organizimin e një vote mosbesimi kundër saj ditën e mërkurë.

May i ka mbijetuar votimit, pavarësisht se një pjesë e madhe e deputetëve të partisë së saj kanë votuar kundër kryeministres britanike sa i përket planit të saj për Brexit.

Për ta siguruar fitoren ajo ka premtuar se do të japë dorëheqje nga pozita e saj si lidere e konservatorëve para zgjedhjeve të ardhshme që do të mbahen në Britani më 2022.

Ndërkohë, të 27 vendet e BE-së kanë thënë se nuk mund të ketë ndryshime në marrëveshjen e Brexit-it dhe kanë thënë se nuk janë të hapur për "rinegociim".

Presidenti francez, Emmanuel Macron, ka thënë se "ne nuk mund të rinegociojmë diçka që është negociuar për muaj të tërë".

Marrëveshja për Brexit është kritikuar për shumë sektorë, mirëpo çështje kyçe ka të bëjë me kufirin që ndan Britaninë me Republikën e Irlandës.

Në një dispozitë të marrëveshjes për Brexit, përcaktohet se Britania do të vazhdojë të jetë pjesë e doganave të BE-së, nëse të dyja palët nuk pajtohen për një tjetër mënyrë që të anashkalojnë kufirin e ashpër.

Ligjvënësit pro Brexitit e kundërshtojnë ashpër këtë plan, pasi sipas tyre, kjo gjë e mban të lidhur Britaninë me rregullat tregtare të BE-së.

Politikanët pro BE-së, në anën tjetër, e konsiderojnë të pamatur mundësinë për të mbetur në bllokun evropian.Prandaj, May u ka thënë liderëve evropianë se për të fituar përkrahjen e britanikëve për marrëveshjen e Brexitit, "ne duhet të ndryshojmë idenë se çështja e kufirit irlandez është kurth për Britaninë, nga i cili nuk do të mund të ikë".

Marrëveshja e negociuar me BE-në, duhet të mbështetet nga deputetët e shumicës në Parlamentin britanik, për të hyrë në fuqi.

Në referendumin e 23 qershorit më 2016, 17.4 milionë persona apo 51.9 për qind e votuesve e kanë përkrahur largimin nga BE-ja derisa 16.1 milionë të tjerë apo 48.1 për qind të tjerë kanë votuar kundër Brexit-it.

Izraeli arreston 40 veta për terrorizëm

TEL-AVIV, 14 DHJETOR - Forcat e Mbrojtjes së Izraelit njoftuan se kanë arrestuar 40 persona të dyshuar për terrorizëm. Në një postim të tyren në "Twitter" të premten shkruhej se 37 prej të burgosurve njihen si operativë të Hamasit. Gjithashtu thuhej se arrestimet pasuan një sulm me armë ditën e enjte, ku u vranë dy ushtarë të Forcave të Mbrojtjes së Izraelit dhe u plagosën disa të tjerë. Agjencia e lajmeve "Associated Press" njoftoi se të ndaluarit janë aktivistë të Hamasit, përfshirë ligjvënës, të cilët u kapën në bastisje të kryera gjatë natës.



VEPRIMTARIA ATDHETARE E SHKRIMTARIT SYLEJMAN KRASNIQIT



Prof. dr. Sabile
KEÇMEZI-BASHA

Kur para gjashtë vjetësh kisha shkruar dhe botuar librin monografik "Sylejman Krasniqi, veprimtaria atdhetare", të cilën e pati financiar dhe përkrahur kryetari i atëhershëm dhe i tanishëm i Komunës së Rahovecit, zotëri Smajl Latifi, të cilin, edhe tani, shfrytëzoi rastin ta falënderojë publikisht, libri u promovua po këtu. Për librin u shprehën shumë e shumë fjalë miradije. Edhe sot, me shumë krenari, mund të flas se atë monografi e kam shkruar me një përkushtim të veçantë, sepse edhe atdhetari e shkrimtari Sylejman Krasniqi ishte i veçantë me punën dhe veprimtarinë patriotike; ishte i veçantë edhe si njeri, edhe si shkrimtar dhe ngeli i veçantë deri në fund të jetës që, me plot vuajtje dhe mall, ia fali Kosovës së vet që aq shumë e deshi.

Atdhetari, shkrimtari, poeti, dramaturgu, publicisti Sylejman Krasniqi lindi më 7 tetor 1937 në Hoçë të Vogël të Komunës së Rahovecit, në një familje atdhetare. Qysh si i vogël merr pjesë nëpër odat e burrave, dëgjon me vëmendje bisedat e pleqve të mençur dhe, si të thuash, pjekët e burrërohet para kohe. Qysh në moshë të re brumohet me taban kombëtar për të qëndruar deri në fund vertikalisht dhe për t'u angazhuar me të madhe për lirinë e atdheut. Si nxënës i dalluar në mësime, ai kishte filluar të merrej edhe me veprimtari patriotike. Sipas aktgjykimit P. nr. 5/53, në Gjykatën e Qarkut të Prizrenit, thuhej se në Gjimnazin e Prizrenit, i cili atë kohë kishte nxjerrë intelektualë dhe atdhetarë të shquar, Sylejman Krasniqi shoqërohet me nxënës përparimtarë, të cilët, krahas mësimit, bartnin mbi supe çështjen e pazgjidhur kombëtare shqiptare. Edhe pse ishin të rinj, ata ishin të vetëdijshëm se vetëm me rezistencë të organizuar mund të kontribuonin për Kosovën e robëruar.

Pikërisht për këtë qëllim formojnë grupin ilegal kombëtar shqiptar, në të cilin ishin përfshirë konviktorët Sylejman Krasniqi, Selim Daut Krasniqi nga Tërpeza e Drenicës, Mehmet dhe Isa Gashi nga Kijeva e Llapushës, Fehmi Hoti nga Krusha e Madhe dhe Isuf Gashi nga Randobrava. Ky grup fillimisht shkruante dhe shpërndante trakte në tërë rrugët e Prizrenit, ndërkaq njëra nga objektivat e mëpastajme të grupit ka qenë informimi i popullit për keqtrajtimin e shqiptarëve në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Sylejman Krasniqi së bashku me grupin ilegal, në programin e organizatës si qëllim suprem të saj kishin vu angazhimin dhe luftën për çlirim dhe bashkim kombëtar. Brenda dy viteve sa veproi organizata, rreth saj dhe në të u anëtarësuan intelektualet atdhetar, që ishin kryesisht të rinj. Ata, në ato vite kishin kryer disa aksione në Rahovec e në fshatrat përreth. Sipas të dhënave që i disponojmë, edhe në grup por edhe më vonë, Sylejman Krasniqi kishte zhvillua një luftë të rreptë kundër sistemit okupues, duke e përgatitur masën se Serbia, Jugosllavia e Titoja janë armiqtë kryesor të popullit shqiptar, dhe me çdo kusht duan ta asimilojnë e ta shkatërrojnë atë.

Më 1952, sa punonte mësues, në shkollën fillore të Dejës, e gris fotografin e Titos, duke e hedhur në mbeturina, ngase i kishte thënë një kolegu "ja, ai atje e ka vendin". Ishte nevrikosur tej mase kur po atë vit ishte fillua me hapjen e shkollave në gjuhën turke, ngase tej mase ishte frikësua se pas kësaj qëndron diçka më e madhe dhe më e lig. Frikësohej se në këtë mënyrë do të fillojë asimilimi i shqiptarëve dhe shpërngulja e tyre për Turqi. Haptas propagandonte që shqiptaret të mos shkojnë në ushtrinë jugosllave, ngase nga atje po na vijnë në arkivole. Në çdo hap ishte kundër sistemit okupues dhe të vetmen zgjidhje e shihte në bashkimin e Kosovës me Shqipërinë ngase, jemi një popull, kemi një gjuhë dhe duhet të jemi një shtet, thoshte ai.

Gjithsesi duhet shtuar se historia e poetëve dhe e poezisë shqipe në ish Jugosllavi mund të thuhej se ndoshta ishte më tragjikja në Evropë. I ashtuquajturi "realizëm socialist" si në asnjë vend tjetër të botës, ka shterpëzuar dhe vrarë gjysmë shekulli të kulturës sonë kombëtare. Kundër krijuesve shqiptarë është ushtruar një dhunë dhe një masakër i programuar dhe i padëgjuar ndonjëherë. Dhe, ishte krejt e pritur se në një sistem totalitar për shqiptaret siç ishte Jugosllavia, që të vërehen, që të survejohen dhe që të hetohen poetet siç ishin Sylejman Krasniqi, Adem Demaçi, Jusuf Gërvalla, Hydajet Hyseni, Zeqir Gërvalla, Rexhep Elmazi, Beqir Musliu e shumë të tjerë.

E sot, mund të shprehemi edhe kështu se disidenca e par e klasës politike okupuese ishin patriotet e shumtë dhe ishin, pikërisht poetët. Poetet ishin ata që me një gjuhë tjetër e shprehen urrejtjen ndaj robërisë dhe dashurin e madhe ndaj lirisë. Ata në këto katrahura e vorbulla të historisë nuk kursyen as jetën. Andaj, sistemi komunist jugosllav i frikësohej tej mase zërit të poetëve,



ndaj kishte vendosur të përdorte grushtin e hekurt, duke ndërsyer kundër tyre punëtoret e UDB-es dhe hetuesit e shumtë për t'i ndjekur ata. Në ish-Jugosllavi, nuk dënoheshin vetëm poetët e shkrimtarët, por në të dënoheshin edhe veprat e tyre, madje përdhoseshin edhe varret ku preheshin eshtrat e tyre. Kush zinte në gojë emrat e "poetëve antijugosllav" kryente një herezi të madhe e mund të përfundonte në biruca, pa gjyq. Sylejman Krasniqi u dënua me 1, 2 muaj burg se kishte lavdërua Fanolin e madhe e kishte përqeshur Titon. Ditët më të rënda të burgut i mbajti në Rahovec, Prizren dhe në Kallugjersko Bare në periudhën 1952-1953.

Pas daljes nga burgu jeta e tij ishte bërë e padurueshme në Kosovë. Ngado që lëvizte, çdo germë që shkruante dhe çdo fjalë që fliste ndiqej e përgjohej nga UDB-ja e asaj kohe. Inkuizicioni shtetëror ishte i dhunshëm, i tmerrshëm dhe rrëqethës. Vendi ishte kthye në një Had të vërtet e të llahtarshëm. Dënimet kapitale që u shqiptoheshin ndaj tyre, shpesh i linte vendin vrasjes apo burgimit të përjetshëm. Në fund të fundit, ishte po e njëjta gjë. Mbyllur në qelitë e kobshme, Sylejman Krasniqi, e shumë poet të tjerë të burgosur lanë nëpër birucat e burgjeve anë e kënd Jugosllavisë, vitet më të bukura të jetës, duke u kthyer në shtëpi me vragat e torturave mizore. Shumë prej tyre s'arritën ta gëzonin as lirinë e vonuar. Përballë një terrori të tillë, nisin përpjekjet për ta braktisur tokën e dashur. Të paktit poetë që mundën të arratiseshin, duke kaluar telat me gjemba të kufirit shqiptaro-shqiptar. Në qershor të vitit 1958, dy vjet pas aksionit të tmerrshëm të armëve, gjatë të cilit u rrahën barbarisht pothuaj të gjithë burrat shqiptarë, pleq e të rinj, Sylejman Krasniqi detyrohet të arratiset në Shqipëri.

Marrja e këtij vendimi të rëndë dhe pastaj rruga e gjatë dhe e mundimshme për kalimin e hekurt të kufirit, e kishte goditur rëndë në mendje e në zemër shkrimtarin. Persekutimi nuk kufizohej vetëm në territorin e ish-Jugosllavisë, por UDB-eja famëkeq i përndiqte kudo që shkonin dhe iu rëndonte jetën. Më tepër se lodhja dhe sakrifica që kishte bërë për ta gjetur shpëtimin dhe dashurinë vëllazërore, e kishte goditur pritja e "ftohtë" dhe provokimet e rënda e të njëpasnjëshme të sigurimit shtetëror të Shqipërisë. Thellësisht i befasuar, por asnjëherë i zhgënjyer dhe i thyer moralisht, kalon disa vjet në kampet e refugjatëve si "emigrant jugosllav" në jug të Shqipërisë. Me gjithë këtë katrahurë, Sylejman Krasniqi ishte i përgatitur moralisht dhe i fortë fizikisht për t'iu bërë ballë këtyre sfidave të papritura e absurde të kohës. Ai para së gjithash e mbi gjithçka tjetër e donte Shqipërinë dhe shqiptarët.

Me kalimin e viteve, shkrimtari Sylejman Krasniqi, fiton të drejtën e shkollimit në Universitetin e Tiranës, ku mbaron me sukses Fakultetin Histori-Filologji, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Një kohë ka punuar si mësues i shkollave të mesme në Mat dhe Tiranë, ndërkaq nga viti 1982, ka dalë shkrimtar në profesion të lirë. Sylejman Krasniqi radhitet ndër figurat më të shquara të letërsisë shqiptare. Ashtu siç e pat cilësuar vite më parë miku i tij Dritëro Agolli, ai ishte Balzaku i shqiptarëve. E disa të tjerë e vlerësojnë si "shkrimtar i të vërtetës historike", ndërsa një kategori tjetër e kritikëve thonë se ka qenë "shkrimtar i rezistencës dhe i frymëzimit të brezave". Sylejman Krasniqi ka qenë shkrimtar i së vërtetës historike dhe simbol i rezistencës e i frymëzimit të brezave me dashurinë ndaj vendlindjes. Ai ishte një figurë komplete si njeri, një intelektual i një kalibri të lartë, një shkrimtar i shquar dhe një atdhetar i flaktë që e donte njësoj çdo pëllëmbë të tokave shqiptare. Këtë e dëshmoi me punën dhe veprën e pavdekshme të tij. Ajo që e detyroi që të arratiset për në Shqipëri ishte përkushtimi për të bërë të pamundurën për çështjen Kombëtare.

Iu përkushtua studimeve dhe letërsisë, të cilat i bënë shoqëri deri në fund te jetës. Romanin e parë e shkroi kur ishte mësues në Klos të Matit, ku ditën jepte mësim e natën ulej të shkruante. Sot ai është shkrimtari i rreth 20 veprave historike, autori i një sërë artikujve dhe shkrimeve gazetareske.

Sulejman Krasniqi me veprën e tij na lë si trashëgimi apoteozën e heroizmit, patriotizmit, sakrificës, përkushtimit dhe trimërisë së shqiptarëve. Ai me të gjithë personazhet e tij, personalitete të historisë kombëtare, personazhet e tij të veprave letrare, i frymëzoi shqiptarët kudo që ndodheshin në përpjekjet e tyre për t'u çliruar nga pushtimi. Vepra e tij ishte një frymëzim i madh për të gjithë ata shqiptar që e donin Shqipërinë, dhe për ata që ranë në burgje anë e kënd Jugosllavisë dhe për ata që bënë luftën e fundit çlirimtare në Evropë, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Lavdi atdhetarit Sylejman Krasniqit.

(Kumtesë e lexuar në tryezën shkencore për Skënderbeun dhe shkrimtarin Sylejman Krasniqi, Rahovec, 7 dhjetor 2018)

E rrallë

Gjuetarët vrasin tufën e ujqërve dhe u hanë zemrën

Dy gjuetarë kanë vrarë një tufë me ujqër në Kazakistan dhe kanë vendosur të ushqehen me zemrën e tyre të gjallë. Në një video të publikuar në rrjete sociale, duket njëri duke ngrënë një kafshatë nga zemra, të cilën ia kalon më pas gjuetarit tjetër.





FOTO E DITES



Shkallet e Stadiumit Olimpik të NSC Kievit të mbuluara nga dëborë. /Reuters/

E jashtëzakonshme

Aeroporti krijon "kutitë e gjumit"



Një aeroport në Amerikë së shpejti do t'ua ofrojë udhëtarëve të lodhur mundësinë për t'u çlodhur në rehati në sajë të një salle me hapësira të posaçme fjetjeje. Sleepbox Nap Lounge është vendosur të hapet në Aeroportin Ndërkombëtar të Washington Dulles në janar, ku secila dhomë ka WiFi, blue-tooth, ndriçim në bazë të humorit dhe një dyshek.

BARSOLETA E DITËS



Babi: - Ku po ikën, moj bijë, tani në gjysmë të natës?
Vajza: - Në banjë, babi, se më duhet urgjentisht një foto e re profili.


Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetem gjate vikendit në ora 14:00





Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr

Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee





Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross

Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI Nëse nuk jeni shumë i bindur për çka do të realizoni vetë, mund të kërkoni ndihmë te persona që dini që ju ndihmojnë pa rezerva.



DEMI Jeni prekur nga përshtypjet jo të mira të dikujt rreth jush. Nuk ka ardhur t'jua thotë përballë, por po i mësoni nga persona të tjerë.



BINJAKËT Nuk e dini se sa mundësi konkrete keni për të realizuar një impenjim të ri. Do të filloni t'i masni mundësitë e suksesit në fund të projektit.



GAFORRJA Edhe pse financat janë të rëndësishme për ju për momentin keni më shumë pretendime në çështjet morale sesa ato financiare.



LUANI Nuk do të keni shumë mundësi të shprehni aftësitë tuaja sot. Edhe në ato raste që do të mundoheni, të tjerët do t'i marrin meritat në vendin tuaj.



Sot do të keni mundësi t'i rekuperoni mungesat e mëdha në familje. Marrëdhënia juaj është e bazuar mbi besimin dhe sot do ta justifikoni.



PESHORJA Jeni të lirë t'i bëni zgjedhjet tuaja në fushën sentimentale, por do të ndikoheni shumë edhe nga ambienti që ju rrethon.



AKREPI Po shikoni mendimet për dhe kundër lidhur me një situatë të caktuar për të vlerësuar në mënyrë sa më korrekte personat e përfshirë.



SHIGJETARI Jeni realist dhe e keni kuptuar mjaft mirë që një marrëdhënie e caktuar nuk po funksionon. Do të tërhiqeni pa lënduar askënd.



BRICJAPI Po silleni shumë qartë dhe hapur me një person të caktuar sepse nuk doni të lini vend për keqkuptime. Në të kaluarën keni rënë pre e llafeve të kota.



UJORI U keni dhënë mesazhe të qarta personave që nuk mendojnë njësoj si ju. Jeni tepër krenar për ta kthyer rrugën që keni nisur.



PESHQIT Dita do të nisë me një përshëndetje, mbase dikush që do të niset në një udhëtim ose ju që keni një udhëtim pune.

Haliey Bieberi me pamje të re



Hailey Bieber, tashmë gruaja e këngëtarit të njohur Justin Bieber, është emri më i lakuar në media, për faktin se është modeluesja më e njohur si dhe për jetën e saj private së bashku me bashkëshortin e saj Justin Bieber.

Ajo në rrjetin social "Instagram" ka postuar një fotografi me flokë të shkurtra. Këtë vendim kishte vendosur të merrte pa ndonjë arsye. Ajo kohët e fundit është përballur me shumë negativitet për shkak të dramës Bieber-Gomez.

Hilary Duff del të shëtisë me foshnjën



Aktorja Hilary Duff u pa të mërkurën rrugëve të Los Angjelosit teksa doli të shëtiste me foshnjën. Duff shihej e lumtur sepse qeshte teksa shëtitej me vajzën e saj. Vajza e Duffit erdhi në jetë në tetor të këtij viti.



Dakota Johnon shkon në palestër

Aktorja Dakota Johnson të enjten u fotografua nga paparacët në rrugët e Los Angjellosit. Ajo u pa teksa ishte duke shkuar në palestër. Johnson pati të veshur tuta ngjyrë të zezë dhe pati të mbathura sandale.

Vanessa Hudgens duket e mrekullueshme



Aktorja Vanessa Hudgens në mëngjesin e ditë së enjte u fotografua nga paparacët teksa shkonte në shoun "Good Morning America". Hudgens pati të veshur një fustan ngjyrë qielli dhe e shoqëroi atë me një bundë të bardhë. Projekti i fundit filmik i aktores është filmi "Princess Switch".

Një bombardim i pamëshirshëm: Si e pushtuan osmanët kryeqytetin e Bizantit, Konstandinopojën

Nga Mark MILLER

Konstandinopoja i kishte rezistuar për shumë shekujt sulmeve armike, derisa më në fund teknologjia e re - topat e mëdhenj të Perandorisë Osmane - e gjunjëzuan kryeqytetin e Perandorisë Bizantine. Rënia e Konstandinopojës në majin e vitit 1453, ishte fundi i një epoke për pjesën më të madhe të Evropës dhe Lindjes së Mesme.

Pasi armët e mëdha bënë punën e tyre, trupat osmane e plaçkitën qytetin e lashtë, dhe masakruan banorët e tij. Gati 4.000 persona u vranë, dhe 50.000 të tjerë u morën si skllevër. Shumë nga banorë kryen vetëvrasje, duke e ditur se ç'do të thoshte të përballeshe me ushtarët osmanë, apo të jetoje si skllav.

Konstandinopoja, ishte kryeqyteti i Perandorisë Bizantine ose siç quhej ndryshe Perandoria Romake Lindore. Ajo u bë gjithashtu një nga qytetet kryesore të Krishterimit. Qyteti e mori këtë emër sipas Perandorit Kostandin, i cili sundoi në shekullin IV-të, gjatë ditëve të para të ngritjes së Krishterimit.

Sot qyteti quhet Stamboll, dhe shumica e banorëve të saj janë myslimanë. Pasojat e rënies së Konstandinopojës ishin të tmerrshme për banorët e qytetit, të cilët u përballën me përdhunime, masakra dhe skllavëri.

Bizantinët arritën t'i zmbrapsin sulmet e mëhershme

Nga fillimi i shekullit XV-të, Perandoria Bizantine kishte nisur të rrudhej, kur osmanët nisën të rrëmbenin territoret e saj. Pos sulmi i osmanëve nuk ishte i pari. Konstandinopoja kishte përballuar shumë të tilla:në shekujt VII-VIII nga arabët, në shekullin IX-X-të nga bullgarët, në shekujt IX, X, XI nga rusët, dhe në shekullin IX nga sllavët.

Në shekullin e XIII ndodhi një sulm nga ana e kryqtarëve, i pasuar nga një pushtim i shkurtër, për shkak se njëra nga portat dalëse të qytetit ishte lënë e hapur. Forcat bizantine brenda qytetit dhe një flotë në port, i penguan pushtuesit për shumë shekuj. Forcat e armatosura të Konstandinopojës kishin një armë sekrete të quajtur Zjarri Grek, i cili ishte një lëng tepër i ndezshëm.

Muret e Konstandinopojës

Por pasuria më e madhe që kishte qyteti, ishin muret e saj mbrojtëse dhe hendeku. Në shekullin e V-të perandori Teodosi II, ndërtoi mbrojtjen e qytetit duke ngritur një seri prej 3 muresh me një gjatësi prej 6.5 kilometrash.

Përveç kësaj, Kostandinopoja ishte vendosur në një gadishull, dhe rrethohej në 3 anët nga uji. Ishte shumë e lehtë të mbaheshin anijet armike jashtë portit, duke vendosur një zinxhir në hyrje. Por këtë herë, në prillin e vitit 1453, vlerësohej se trupat që mbronin muret e qytetit ishin vetëm 5.000, dhe qyteti kishte vetëm disa anije për t'u mbrojtur nga anijet armike. Forcat bizantine ishin të pakta, të armosura dobët, dhe shumë pak anije.

Osmanët kërkojnë dorëzimin e Konstandinopojës

Më 5 prill, sulltani osman Mehmeti II, u vendos me ushtrinë e tij jashtë qytetit, duke i dërguar fjalë Konstandinit IX të dorëzonte qytetin. Konstantini nuk ktheu përgjigje. Mehmeti ishte i vendosur të nënshtronte kryeqytetin e lashtë, dhe ai kishte një forcë të fuqishme që e mbështeste në këtë synim.

Mehmeti kishte diçka që nuk e kishin pasur të gjithë ata që kishin sulmuar me herët Kostandinopojën:armë të mëdha të rrethimit, të projektuara nga një hungarez i quajtur Urban. Dhe Mehmeti kishte një forcë ushtarake që vlerësohej nga 60.000- 200.000 njerëz. Ai gjithashtu kishte një flotë që priste aty pranë, për të hyrë në port.



Armët e rrethimit të osmanëve ishin të frikshme. Njëra nga armët ishte 9 metra e gjatë dhe 3 metra e gjerë. Ajo mund të lëshonte një top prej 500 kilogramësh, në një distancë prej më shumë se 1.5 kilometrash. Arma do të nxehej aq shumë, sa që mund të përdorej vetëm 7 herë në ditë. Por osmanët kishin topa të tjerë të fuqishëm, që mund të gjuanin deri në 100 herë në ditë.

Një bombardim i pamëshirshëm

Më 6 prill, armët gjigante nisën t'i shkatërronin muret e frikshme të Konstandinopojës. Mbrojtësit i hodhën poshtë sulmuesit nga vrimat e mureve, dhe u përpoqën t'i riparonin të çarat vrima gjatë natës. Ata vetë gjuatën me topa shumë më të vegjël. Mbrojtësit e Konstandinopojës rezistuan për 6 javë.

Ata i zbrapsën për një farë kohe anijet osmane në hyrje të portit. Por osmanët ndërtuan një platformë përgjatë vijës së rrethimit, dhe i transportuan nga toka 70 anijet e tyre deri në port. Ata filluan të bombardonin muret më të dobëta përbri detit.

Rebelim në shtëpi

Në fund të muajit maj, perandori osman mësoi se disa nga nënshtetasit e tij në Azinë e Vogël po rebeloheshin, tani që ushtria ndodhej larg. Mehmeti i bëri një ofertë Konstandinit IX:Ky do të paguante një haraç, dhe osmanët do të tërhiqeshin duke i dhënë fund rrethimit.


Mehmeti shpresonte të kthehej shpejt në Azinë e Vogël, por Konstandini refuzoi. Dhe ky rezultoi një gabim tragjik. I tërbuar nga inti, Mehmeti u tha njerëzve të tij se mund ta plaçkisin qytetin dhe të bënin çdo gjë me të, kur ai të kapitullonte. Dhe Konstandinopoja qe një nga qytetet më të pasura në botë.

Më 29 maj, Mehmeti nisi një sulm total mbi qytetin, duke dërguar trupa më të fuqishme kundër saj në 3 valë goditjesh. Sulmi i fundit nga jeniçerët, trupat e tij elitë, solli shkatërrimin e Konstandinopojës. Sërish, një portë e vogël ishte lënë e hapur në një nga muret, e cila u lejoi jeniçerëve të hynin në qytet.

Ata ngritën flamurin osman në qytet, më pas hapën portën kryesore, dhe lejuan hyrjen e pjesës së mbetur të ushtrisë. Konstantinopoja dikur e paprekshme, kishte rënë. Në momentet e fundit të dëshpëruara, qyteti u mbrojt në disa prej mureve nga gratë dhe fëmijët.

S'ka nevojë të thuhet se ata u kapën shpejt. Disa prej tyre ikën me vrap në shtëpitë e tyre për të mbrojtur familjet e tyre. Të tjerët në mbrojtje të kishave. Ky nuk qe një veprim i mençur, pasi kishat e qytetit ishin të pasura me ar dhe xhevahire të ndryshme të çmuara.

Trupat osmane i thyen ikonat, statujat, afresket dhe kishat e krishtera përfshirë Kishën e Shën Sofisë. Mehmeti hyri në qytet më vonë gjatë asaj dite, dhe tha se kisha e madhe madhështore do të shndërrohej në një xhami. Sapo hyri, ai urdhëroi fundin e masakrave. Pas rënies së Konstandinopojës, Mehmeti e bëri atë kryeqytetin e tij të ri. Pak kohë më vonë ra edhe pjesa tjetër e Perandorisë Bizantine, duke u bërë pjesë e Perandorisë Osmane.



(Ancient Origins - Bota.al)

Jeni ‘single’? Këshilla për të mbijetuar në kohën e bukur të festave!

A ju trishtojnë familjet e vogla të mbledhura rreth pemës së Krishtlindjes? Zbuloni sesi të jetoni sa më mirë dhe me autenticitet periudhën më të ëmbël të vitit



Le të jemi të qartë: Krishtlindjet nuk janë momenti më i favorshëm për ata që janë single. Nuk është gjithmonë e lehtë për të gjetur shoqëri, sepse janë të shumtë ata që kanë angazhime familjare dhe duan ta festojnë festën në intimitet rreth të afërmve, të tjerët preferojnë të qëndrojnë vetëm me parterin e tyre, madje vihemi në siklet nga numri i shumtë i shoqërisë çift. E megjithatë, kalimi i Krishtlindjeve në shoqëri të mirë, nuk është aq i vështirë dhe ku i dihet festat mund të jenë gjithashtu një rast për një takim të ri.



Çështje zemre – Si gjithmonë, shumë varet nga qëndrimi me të cilin ne përballemi me situatën. Është e ndaluar të bini në depresion, të bëheni melankolik (ok, një çlirim i vogël lejohet, por jetëshkurtër!), si dhe mos e akuzoni veten. Të qenit single është një fakt, të paktën i përkohshëm, me të cilin ne jemi të detyruar të bëjmë llogaritë. Prandaj duhet ta përballojmë me humor të mirë dhe gjithashtu me pak zhurmë: duhet t’i kujtojmë vetes që jemi në kushtet që qindra mundësi mund të shfaqen dhe kështu që na mbetet vetëm të vendosim. Në fakt, ne duhet t’i përgjigjemi vetëm vetes dhe të bëjmë atë që na pëlqen më së miri.

Të shohim përpara – Nëse melankolia po na torturon, le të çlirohemi pak: le të analizojmë arsyet pse ndihemi të trishtuar dhe përpiqemi të kuptojmë nëse mund të gjejmë një përgjigje të paktën të pjesshme ndaj dëshirave dhe nevojave tona. A ndiejmë nostalgji për familjen? Ndoshta një mbrëmje për ta kaluar me një prind ose një vëlla mund të jetë një zgjidhje, edhe nëse harmonia nuk është në kulmin e saj dhe ndoshta nuk ka qenë për pak kohë: në fund të fundit, Krishtlindja është koha për të shuar grindjet dhe për të rregulluar marrëdhëniet me njëritjetrin. Por, së pari le të bëjmë një vlerësim të kujdesshëm të raportit kosto-përfitim dhe pastaj të marrim vendimet tona. Dhe nëse nuk gjejmë një



strategji ngushëllimi, le të mos mendojmë fare për këtë gjë: më mirë t’i përqendrojmë energjitë tona për ndonjë projekt të



ndjeheni të vetmuar, një rrezik që mund të bini lehtë është të mbushni orarin me angazhime për të pasur gjithmonë diçka



këndshëm për Krishtlindje.

Jo gjëra të bëra pa dëshirë – Kur për të bërë. Kjo është një strategji e kuptueshme, por jo gjithmonë efektive. Përveç kthimit të periudhës së festive në një maratonë ushqimi, pijesh, darkash dhe përshëndetjesh, na vjen ndërmend një pyetje: a jemi të sigurt që të gjitha këto i kemi bërë me zemër? Nëse po, le t’i shijojmë. Në fund të fundit, fundviti është periudha më e shndritshme dhe festive që mund të dëshironi. Nëse, nga ana tjetër, në gjysmën e rasteve kemi të bëjmë me takime që janë me pak ose aspak interes për ne dhe që mund të na lënë edhe me një shije të hidhur, nuk hezitojmë të themi jo. Ne zgjedhim me kujdes ngjarjet dhe fokusohemi tek ato. Një mbrëmje e qetë në shtëpi, para një filmi të mirë ose me një libër të mirë për të lexuar dhe një gjumë të mirë është gjithmonë një program që ka arsyen e vet.



I bëni vetes një dhuratë – Nuk mund të organizonim një vit të ri që na kënaq? Le t’i dhurojmë vetes një udhëtim ose një pushim të shkurtër. Mjafton një buxhet i vogël dhe disa ditë pushim, madje edhe në vende jo shumë larg, për të vizituar një qytet që na intrigonte prej kohësh, ose për të parë një ekspozitë arti ose një ngjarje muzikore. Udhëtimi vetëm na zemëron? Mund të zgjedhim një udhëtim në grup (jo domosdoshmërisht vetëm): do të jetë një mundësi për të bërë miq të rinj. Dhe në qoftë se për mbrëmjen e Vitit të Ri nuk jemi në shoqëri, festat në rrugë tani janë aq të përhapura dhe mund të jetë një mënyrë për të zbuluar një qytet natën dhe për të kaluar gëzueshëm në mes të njerëzve… edhe pse nuk i njohim.

Një përkëdhelje e gjitha për ne – Dimri është momenti i madh i mirëqenies. Një dhuratë tjetër që ne mund t’i bëjmë vetes për Krishtlindje është abonimi në një qendër spa ku mund të relaksohemi në pishina të nxehta, sauna dhe çajërash aromatikë. Dhe në qoftë se ne me të vërtetë duam të shpërblehemi, mund të shtojmë një masazh tonik dhe revitalizues. Ajo do të na ripërtërijë dhe do të na bëjë të pajtohemi me veten.

Mendojmë për të tjerët – Nuk ka mënyrë më të mirë për ta dashur veten sesa për të qenë bujar me të tjerët. U japim pak kohë nga koha jonë atyre që kanë nevojë, për shembull duke marrë pjesë në ndonjë iniciativë bamirësie ose solidare. Kujdes: nuk mjafton thjesht të bërit e ndonjë oferte. Ne duhet ta përfshijmë veten me ndonjë gjest konkret, si duke marrë pjesë në ndonjë event bamirësie apo në ndonjë iniciativë sociale. Në fund, do të zbulojmë se kemi marrë shumë më tepër nga ajo që kemi dhënë.



Autor: GAZMEND MORINA	HUMBJA E AFTËSISË PËR TË LËVIZUR	SHKRIMTARE E JONA	GJYQTAR SPORTIV	FUSHA KU ZHVILLOHET NJË PËRLESHJE (fig.)	DJALI KUNDREJT PRINDËRVE TË VET (pashq.)	SHTET NË AZI (pashq.)	KONOPI	ZANORE	EPOKA E RE	PIANISTJA LULE	KËNGA E POPULLARI-ZUAR
VIJA E LAKUAR E HAPUR, QË PËRFTOHET KUR PRITET KONI ME NJË RRAFSH PARALEL									ELIZA HOXHA / SULMIMI		
ANËTARËSIMI NË NJË ORGANIZATË								LETRARI ASLLANI			
KUMTIM I GJERË ME SHKRIM, QË MBAHET PARA NJË MBLEDHJEJE								VITI I RI KINEZ (pashq.) / GOJËDHËNA			
AKTORI FRANCEZ .... DELON					FALJA FETARE QË BËJNË DISA HERË NË DITË / MYSLIMANËT						
AKTORI YNË ÇELAJ						KËNGËTARI I FAMSHËM .... MARTIN / KËNGËTARJA AMERIKANE .... TARNER					MJET I THJESHTË LUNDRIMI (shq.)
INDIUM			VULGARE, E NDYRË	PEZMATIMI I VESHIT / THIRRJA E MYEZINIT						BASHKËTING. / LUMË NË KOSOVË	
KORIJA							EMËR YNI MASHKULLI / PJESË E BRENDSHME E KËMISHËS				

EPOKA E RE	FUTBOLLISTI HOLANDEZ NË FOTO (BAYERN MUNICH)	SUPER MODELJA ANGLEZE CAMPBELL	VESHJE E TRASHË, E BËRË ME LESH DHIE SI NJË PELERINË (krah.)	OHAJO, FLORIDA	BASHKËTING.	FEMRA LUFTËTARE (mit. greke) / ZHVILLIM JONORMAL								ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk.) / I MITUR, KALAMA			
SHTET NË AFRIKË							PEMË E VENDEVE TROPIKALE (shq.) / ISMET MUNISHI								EVA PEPAJ / PRINC ARAB (shq.)		
KOMPOZITORI .... DHOMI					ISH TRAJNERI YNË I BOKSIT LAH ..... / PAJISJE PËR ALARMIM (sh.shq.)							MJET UDHËTIMI (shq.) / PËRÇARJE					
DET I YNI				SHTET NË AFRIKË (pashq.) / DEVE E VENDEVE TË AMERIKËS (sh.shq.)							MUZIKANTI KRASNIQI (shq.) / JETA E QETË DHE E LUMTUR						TINGULL QË FORMOHET NË MAJË TË GJUHËS (gram.)
SMALTIM							JA (bised.) / RENS ISTVUD			INDIAN DEFENCE REVIEË / E KUJDESSHME NE VEPRIME				U ARRATISA NGA BURGU / POLITIKANI SHEHU			
NORA ISTREFI			BUJKU / ARIAN MALIQI						SOLISTJA ... ZARI / NJOLLOSJA				ORGANIZMI I NJERIUT (pashq.) / SHFUQIZIM				
BASHKËTING.		BAR PËR TË DALËË JASHTË (shq.) / SHKARKIMI NGA NJË POZITË						I DËRGUARI SPECIAL / SULFUR, NATRIUM								ZANORE / ROBERT REDFORD	
RAFTI, DOLLAPI							DIKTATOR SOVJETIK (shq.) / PRAROJ								RIFAT KUKAJ / SKUADRA SPORTIVE		
BETIM			TONY ANDERSON / BËRTHAMOR			NJËRI NGA AKUZUESIT E SOKRATIT / ENVER PETROVCI						U THAVA / BASHKËTING.					
SUPER MODELJA HERZIGOVA				KA A DEM I PATREDHUR (shq.) / LLOJ PAPAGALLI							BURRË I MOSHUAR / RROGA VJETORE E PAPËS					SHKRONJA XVI / LLOJ PIJE E NGROHTË ORIENTALE	
SHENJA QË PËRFAQËSON NJË TINGULL MUZIKOR					FJALË POHUESE / AKTORI HOLLIVUDIAN .... PIT			FRYMA VEZAK, QË ËSHTË NË TRAJTË TË VEZËS				I FILLOVE / ONTARIO LACROSSE ASOCIATION					
TOKË ME TË ARDHURA VJETORE DERI NJËZET MIJË AKÇE NË VIT, QË U JEPEJ NË ZOTËRIM FEUDALËVE SPAHINJ NË PERANDORINË OSMANE (shq.)	ZOG ME TRUP TË MADH E ME PENDË TË ZEZA / TANTAL, FOSFOR					NË DITËN E SOTME / IPSVICH				LIGJ (vjet.) / "TOP ALBANIA RADIO"				MINUS (Mat.) / BUKURI, HIJESHI			BISHË MALI (pashq.)
							QË KA TRUP TË SHËNDOSH, JETËDHËNËS / BASHKËT.						MUZIKANTI ADRIAN / RADIUM				
EMËR FEMRE MYSLIMANE						BAKËRPUN-UESI / ZANORE									EDUARD ROSTON / ZANORE		
LLOJ LOJE ME SHIGJETA TË VOGLA							MUNGESË E SHTYPJES, E VARËSISË DHE E KUFIZIMEVE					ZEZAKU, I ZIU					

Zbulohet sekreti i flokëve të kuq

Studiuesit kanë realizuar studimin më të madh ndonjëherë për të zbuluar sekretin e vërtetë pas flokëve të kuq: janë tetë gjene. Përveç kësaj, ekspertët kanë gjetur edhe gjene që ndikojnë në ngjyrosjen e flokëve në përgjithësi, si dhe mënyrën se si rriten, përfshi këtu kaçurrelat apo ata të drejtët.



Shkencëtarët kanë zbuluar se ka tetë gjene që ndikojnë në lidhje me flokët e kuq. Hulumtimi, i cili gjithashtu hedh dritë mbi flokët bjonde dhe ngjyrë kafe dhe ky është studimi më i madh gjenetik mbi ngjyrën e flokëve deri më sot, dhe ne shohim së bashku sekretet e flokëve të kuq të zbuluara nga studiuesit në Universitetin e Edinburgut.

Një hap mbrapa. Deri më sot mendohej që flokët e kuq kontrolloheshin nga një gjen i vetëm i quajtur MC1R. Studimet e mëparshme kishin treguar se e kuqja trashëgoheshe nga dy versione të gjenit MC1R përgjegjës për ngjyrën e kuqe që erdhi nga një nënë dhe një nga baba. Por në fakt ka vetëm një version. Edhe pse ata që kanë flokë të kuq janë në dy versione, në fakt është vetëm një gjen përgjegjës.

Studimi

Për të kuptuar më shumë, hulumtuesit në Universitetin e Edinburgut shqyrtuan ADN-në e rreth 350,000 njerëzve që kishin marrë pjesë në një studim nga banka britanike. Studimi, i kryer nga Instituti Roslin dhe Njësia e Gjenetikës së Njeriut MRC, u përqendrua tek njerëzit me origjinë evropiane, sepse ata kanë një ndryshim më të madh në ngjyrën e flokëve. Duke krahasuar njerëzit me flokë të kuq me ato me flokë ngjyrë kafe ose të zezë, shkencëtarët ishin në gjendje të identifikonin tetë dallime gjenetike të panjohura të lidhura me flokë të kuq. Ekipi gjithashtu shqyrtoi funksionet e gjeneve të identifikuara dhe gjeti se disa prej tyre funksionojnë duke kontrolluar "kalimin në" dhe "mbylljen" e gjenit MC1R. Dhe kjo nuk është e gjitha.

Flokët e tjerë

Përveç gjeneve me flokë të kuqe, studiuesit kanë zbuluar dallimet në rreth 200 gjene të lidhura me biondet dhe brunet. Shkencëtarët thonë se ka një gradient ngjyrash nga e zeza, kafja e errët deri te kafja e çelur, e cila është shkaktuar nga rritja e numrit të dallimeve gjenetike në këto 200 gjene. Ekspertët thonë se ata ishin të befasuar për të gjetur se shumë nga këto 200 dallime gjenetike ishin të lidhura me strukturën e flokëve dhe jo me pigmentim. Gjenet tjera, nga ana tjetër, janë të përfshira në përcaktimin se si flokët rriten, të kaçurrela dhe të drejta.

(gazeta-Shqip.com)


Pse kur shajmë na bën mirë për shëndetin (mendor)

Që nga fëmijëria, ne mësohemi të "mos themi fjalë të këqija", edhe pse një hulumtim i bërë në SHBA ka zbuluar se "fjalët e këqija" përbëjnë gati një për qind të fjalorit të përditshëm. Mundësitë për të shqiptuar keqkuptime të papërshtatshme në kohë të gabuara janë mjaft të dukshme, por ka raste që kur i "lëmë fare" është mirë dhe madje mund të jetë e dobishme për shëndetin tonë. Ja pse.

Ndihmon në menaxhimin e dhimbjeve

Të vrasësh këmbën me ngut te qoshja e derës: kujt nuk i ka ndodhur? Por, në qoftë se këmbët tuaja nuk ju dhembin më, pasi e keni sharë, nuk është rastësi. Një studim i kryer në Universitetin Keele në Mbretërinë e Bashkuar ka matur efektet e imprecimit në tolerancën e dhimbjes dhe zbuloi se ne mund të durojmë dhimbjen kur jemi vulgar. Pse? Çdo fjalë e ndyrë dërgon një mesazh në tru: nuk janë termat individualë që kanë këtë fuqi, por është reagimi emocional dhe fizik që ne nxisim duke shqiptuar ato, që na jep atë ngarkesë të energjisë që na nevojitet në atë moment.

Përmirëson stërvitjet tuaja



Gjatë një stërvitjeje veçanërisht të lodhshme, ju do të shani instruktorin: nëse e keni bërë atë me zë të lartë, ai gjithashtu mund të përfitojë nga performanca juaj. Kjo mbështetet nga hulumtimi i Universitetit Keele, i cili zbuloi se ata që shajnë në mënyrë eksplicite e rritën performancën me 2-4 për qind dhe forcën prej 8 për qind në krahasim me ata që mbanin mbyllur gojën. Studiuesit kanë supozuar se kur "vuani në heshtje", ju vetëm mendoni se sa i vështirë dhe i lodhshëm është trajnimi, ndërkohë sharja ju devijon vëmendjen dhe ju lejon të punoni më mirë.

Çliron stresin

Sharjet mund të përdoren gjithashtu si një "lëshim emocional" efektiv, veçanërisht kundër zemërimit dhe frustrimit. Përdorimi i fjalëve që nuk janë të mirëpritura ose të përshtatshme mund të jenë shumë çliruese. Fjalët e këqija zakonisht shqiptohen me zemërim ose frustrim dhe i gjithë trupi është i përfshirë. Kur ne zemërohemi pa u sharë, ne ende po kontrollojmë veten: në këtë rast stresi nuk lirohet. Kur i praktikojmë, megjithatë, ne përfshijmë tërë trupin dhe emocionet: çlirimi është i plotë dhe prandaj lehtëson stresin.

Ndihmon për të shprehur veten

Dikush mund të mendojë se thënia e fjalëve të këqija shpesh është shenjë e një fjalori të kufizuar, por një studim i botuar në revistën 'Language Sciences' tregon se në të vërtetë është e kundërta. Studimi analizoi një grup prej 43 burrash dhe grash, duke shqiptuar sa më shumë fjalë të këqija në një minutë. Më pas, ata duhet të përmendnin numrin më të madh të kafshëve në të njëjtën kohë. Studiuesit zbuluan se sa më shumë fjalë të këqija të ishte në gjendje të thoshte një pjesëmarrës, aq më shumë i shumëllojshëm ishte fjalori i tij.

Ju bën të dukeni më të ndershëm dhe autentik

Sharja mund t'i bëjë njerëzit të duken të sinqertë. Nëse jemi në një kontekst pozitiv (dhe miqësor), do të dukeni të sinqertë, autentikë dhe bindës, sepse sharja është një formë e shprehjes së papërpunuar, të pafiltruar dhe instinktive. Një studim i kohëve të fundit zbuloi se vulgariteti është i ndërlidhur me ndjenjat dhe emocionet e vërteta në ndërveprimet shoqërore, duke treguar se ata që shajnë, janë ndoshta edhe më të sinqertë.

(gazeta-shqip.com)



Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	ASTON VILLA - STOKE	1	EXETER - CREWE	2	VALLADOLID - ATLETICO MADRID	2

Krasniqi: Besës i ka mbetur vetëm emri

Festim Krasniqi, që ishte një prej lojtarëve më të mirë në skuadrën e Besës, ka treguar për "Epokën e re" se aventura e tij me klubin pejan ka përfunduar. "Kam shkuar në skuadrën e Besës me dëshirë dhe vullnet të madh, por ajo nuk ka qenë aspak korrekt me mua. Kam pritur se do të jetë krejt ndryshe për faktin se Besa është një klub me traditë, por ky nivel tregon se këtij klubi i ka mbetur vetëm emri. E kam njoftuar edhe klubin se në pranverë nuk do të jem pjesë e tij", ka thënë Krasniqi



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Futbollisti Festim Krasniqi me sukses i mbrojti ngjyrat e skuadrës së Besës në sezonin vjeshtor, duke qenë një nga lojtarët më të mirë për skuadrën pejane. Megjithatë, ai është ndarë i zhgënjyer me atë që ka përjetuar në këtë klub, prandaj ka vendosur edhe të largohet përfundimisht, për të gjetur një klub të ri. "Kam shkuar në skuadrën e Besës me dëshirë dhe vullnet të madh, por ajo nuk ka qenë aspak korrekte me mua. Kam pritur se do të jetë krejt ndryshe për faktin se Besa është një klub me traditë, por ky nivel tregon se këtij klubi i ka mbetur vetëm emri. E kam njoftuar edhe klubin se në pranverë nuk do të jem pjesë e tij", ka thënë Krasniqi për "Epokën e re".

Aktualisht Besa e Pejës është në pozitën e dytë në Ligën e Parë të Kosovës në futboll me dy pikë më pak se skuadra e Vushtrrisë, kurse është eliminuar nga gara e Kupës. Festim Krasniqi ka thënë se, po të shkonte gjithçka sipas planprogramit të Ismet Munishit, rezultatet do të ishin shumë më të mira. "Nuk besoj se kanë qenë rezultate aq të mira. Po të punohej sipas planprogramit të trajnerit Ismet Munishi, gjithçka do të ishte më mirë. Këto probleme na kanë penalizuar, pasi Besa ka mundur të jetë në pozitën e parë me diferencë pikësh", ka shtuar ai.

Autori i tetë golave me Besën e ka përjashtuar çdo mundësi që të vazhdojë të jetë pjesë e skuadrës pejane pasi ende nuk i ka kryer shumë obligime ndaj futbollistit në fjalë. "Nuk do të vazhdoj të luaj për Besën edhe po qe se i kryen të gjitha obligimet ndaj meje. Mund të them se ky gjashtëmujor ka qenë ndër më të mundimshmit në karrierën time. Me Besën i kemi ndarë rrugët dhe shumë shpejt do të vendos për të ardhmen", ka deklaruar Krasniqi.

Futbollisti në fjalë ka konfirmuar bisedimet me skuadrën e Vëllaznimit nga Gjakova, por ka treguar se ende nuk është arritur ndonjë marrëveshje. Festim Krasniqi ka bërë karrierë në shumë klube të Kosovës. Përveç Besës, ka djersitur edhe fanellën e Trepçës '89, Vllaznisë së Pozharanit, Llapit, Prishtinës, Vushtrrisë dhe Dritës, kurse në Shqipëri ka luajtur për Partizanin dhe Laçin.

SHKURT

Ballkani prezanton Hajdinin

Skuadra e Ballkanit e ka prezantuar si përforcim të ri të skuadrës Bledar Hajdinin, i cili vjen si huazim nga skuadra e Llapit. "Bledari është i huazuar nga FC Llapi në skuadrën tonë dhe është prezantuar nga drejtori sportiv Lulzim Kolgeci dhe menaxheri i skuadrës, Idriz Hajrizi. Faleminderit për mundësinë dhe bashkëpunimin FC Llapit dhe Tahir Batatinës!", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ballkanit.

Ademi nderoi doajenët e gazetarisë sportive

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i ka nderuar me nga një shpërblim të veçantë doajenët e gazetarisë sportive: Agim Kasapollin, Azem Brovinën, Xhavit Kajtazin, Gani Kosumin dhe Blerim Vuniqin. "Ne si FFK kemi vendosur t'i nderojnë disa prej kolegëve tuaj të cilët kanë dhënë shumë për gazetarinë dhe sportin", ka thënë Ademi në pritjen që u ka bërë gazetarëve sportivë me rastin e festave të fundvitit.

Chelsea dhe Arsenali në garë për Hysajn

Elseid Hysaj me shumë mundësi do të largohet në verën e vitit 2019 nga skuadra e Napolit. Ka pasur shumë raportime rreth së ardhmes së tij, i cili kërkohet me ngulm nga Chelsea që drejtohet nga Maurizio Sarri. Trajneri italian e njeh mirë Hysajn dhe londinezët nuk duan të bëjnë eksperimente. Për mbrojtësin shkodran interesohet edhe Arsenali, që kërkon një mbrojtës të djathtë.

Kloppi: Shaqiri nuk më surprizoi

Liverpool, 14 dhjetor - Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, nuk është i suprizuar se sa shpejt është ambientuar Xherdan Shaqiri në skuadrën e Liverpoolit. "Nuk jam surprizuar dhe aq nga mënyra se sa shpejt u ambientua me ekipin Xherdan Shaqiri. Thjesht kërkoja të tregonte atë çfarë ka dhënë dhe më përpara, prandaj nuk jam i surprizuar. E prisja", ka thënë Kloppi.

Trajneri gjerman më pas foli edhe për ndeshjen derbi ndaj Manchester Unitedit, duke thënë se "redsat" do të japin gjithçka për fitore. "Lojtarët flasin me njëritjetrin në dhomat e zhveshjes dhe përgatiten. Është një ndeshje si gjithë të tjerat, ku do të japim gjithçka për të fituar. Nga pikëpamja historike është një ndeshje e madhe, kështu që jam i nderuar të quhet si klasikja e Anglisë. Kam qenë pjesë e klasikes gjermane, gjithashtu. Nuk kam qenë kurrë i interesuar për pikët e Unitedit. Kam qenë i vetëdijshëm për kritikat që i janë bërë por, në qoftë se i analizon si ekip, kanë shumë kualitete. De Gea në portë, Pogba, apo Rashford, Lukaku e Lingard, janë që të gjithë lojtarë të pabesueshëm", ka deklaruar Kloppi.


Joshua cakton datën 13 prill për përballje me Wilderin

Londër, 14 dhjetor - Kampioni i botës në peshën e rëndë, boksieri britanik Anthony Joshua, ka konfirmuar se më 13 prill ka caktuar stadiumin "Wembley" të Londrës për t'u përballur ndaj kampionit tjetër të këtij divizioni, amerikanit Deontay Wilder.

"Unë mezi po pres të dueloj ndaj Wilderit më 13 prill në Londër. Ky është një mesazh i qartë dhe i drejtpërdrejtë që i dërgoj atij. Nuk kam se çfarë të them tjetër", ka thënë Joshua. "Unë nuk e di se çfarë mendon apo çfarë dëshiron Wilderi. Po ashtu, nuk mund të kontrolloj atë që dëshiron, mendon apo do Tyson Fury. Unë kontrolloj fatin tim, atë që dëshiroj unë të bëj. Unë kam bërë të mundur që negociatat të nisin me kohë, kam rezervuar kohë më parë stadiumin për këtë sfidë të madhe dhe mezi po pres të përballem me këta djem në ring, veçanërisht me Wilderin, më 13 prill, në 'Wembley'. Nuk di se çfarë i pengon ata", ka deklaruar Joshua, i cili nuk dëshiron përballjen me Tayson Furyn, me arsyetimin se ai nuk është kampion i botës.



Të hënën shorti i Ligës së Kampionëve dhe Evropa Ligës



NION, 14 DHJETOR - Me uljen e siparit në Ligën e Kampionëve dhe Evropa Ligë, UEFA po programon shortin që do ta ravijëzojë edhe më tepër betejën për dy trofetë e futbollit kontinental, tashmë në përplasje të drejtpërdrejta. Në orën 12:00 të së hënës pretendentët për fronin do t'i mësojnë rivalët e tyre, edhe pse në fushë do të zbresin vitin që vjen. Ndeshjet e para do të luhen më 12 dhe 13 shkurt, si dhe më 19 dhe 20 shkurt, ndërsa ato të kthimit në muajin mars. Rregullat për vazot në Nion janë të qarta dhe me dy grupime, ato që dolën të parat dhe ato të kualifikuara pas tyre. Asnjë skuadër nuk do të mund të sfidojë një ekip që ka luajtur më parë në grup, apo brenda të njëjtit shtet. Një orë pas shortit të Ligës së Kampionëve, të hënën do t'i mësojnë kundërshtarët edhe ekipet e mbijetuara në Evropa Ligë. 32 skuadrat e kualifikuara, 24 nga grupet e Evropa Ligës dhe tetë të tjera që vijnë nga Liga e Kampionëve, si vende të treta, janë ndarë në dy vazo. Në vazon e parë janë vendosur skuadrat që e mbyllën grupin në vendin e parë dhe ekipet e treta më të mira që vijnë nga Liga e Kampionëve. Skuadra të mëdha të vazos së parë, si Chelsea, Arsenali, Interi apo Napoli, shpresojnë t'i shmangin përplasjet me kundërshtarë të fortë si Lazio, Sporting apo Shakhtar Donetsk. Në bazë të rregullores, në këtë raund nuk mund të ketë përplasje të skuadrave nga i njëjti shtet.

Fitojnë Houstoni dhe San Antonio

HOUSTON, 14 DHJETOR - Skuadra e Houstonit fitoi 126-111 ndaj lakersave, suksesi i dytë radhazi për skuadrën teksane, që fitoi një përballje mes dy ekipesh pretendente për titull në Perëndim. Hardeni ishte fantastik në këtë sfidë, duke realizuar 50 pikë, 10 rebounde e 11 asistime, më i miri në fushë, ndërsa për lakersat u dallua LeBroni me 29 pikë e Kuzma me 24, por që mbetën për statistikë. Fiton edhe San Antonio që triumfoi 125-87 ndaj Clippersit, duke u shkëputur nga perioda në periodë, një fitore e lehtë e ekipit të Spursit, që i largohet fundit të renditjes në Perëndim. Shtatë lojtarë të skuadrës së San Antonios realizuan mbi 10 pikë, me Aldridgen me 27 pikë ishte shënuesi më i mirë, ndërsa për Clippersin mungoi lideri. Ekipi i Phoenixit mundi 99-89 Dallasin, ndeshje ku u dallua Warreni me 30 pikë, më i miri në fushë, ndërsa Orlando triumfoi 97-91 ndaj Chicagos në sekondat e fundit, sfidë ku u dallua Vuqeviqi, autor i 26 pikëve e 10 rebaundeve.



REZULTATET

Houston - Lakers	126-111
San Antonio - Clippers	125-87
Orlando - Chicago	97-91
Phoenix - Dallas	99-89

SHKURT

Ky është dënimi i UEFA-s për Milanin

UEFA ka marrë vendimin për gjyqin e Milanit për sa i përket dështimit për t'i përmbushur standardet e "fair-play"-t financiar nga ana e klubit kuqezi. Seanca ishte shtyrë për të premten si pasojë e ndeshjes që Milani do të luante të enjten ndaj Olimpiacosit dhe pikërisht disa çaste më parë është dhënë vendimi përfundimtar. Organi më i lartë qeverisës i futbollit evropian ka dalë në një njoftim zyrtar, duke komunikuar vendimin. Klubi kuqezi do të marrë një gjobë prej 12 milionë eurosh, si dhe ka afat deri më 30 qershor 2021 për t'i rregulluar bilancet. Gjithashtu, përveç kësaj, klubi nga Milano do të ketë reduktim lojtarësh në dy sezonet e ardhshëm në kompeticionet evropiane, duke mos regjistruar më shumë se 21 lojtarë. Në rast se klubi i Milanit nuk do ta përmbushë rregullimin e bilanceve deri në fund të sezonit 2020/2021, atëherë dënimi do të përshkallëzohet, në të paktën një vit përjashtim nga kompeticionet e UEFA-s.

Havertzi refuzon Barçën, shkak Bayerni

Talenti i Bayer Leverkusenit, Kai Havertz, e ka refuzuar ofertën e skuadrës së Barcelonës. Lajmi është bërë me dije nga spanjollja "Mundo Deportivo", kurse Havertz besohet se është afër marrëveshjes me Bayern Muncheni. 19-vjeçari gjerman nga Barcelona shihet si një zëvendësues ideal për mesfushorin e Kroacisë, Ivan Rakitiq. Havertzi është pjesë e ekipit të parë të Bayer Leverkusenit nga viti 2016, kurse ka regjistruar 67 paraqitje dhe ka shënuar 11 gola.

Navasi nuk pranon rolin e rezervistit, afër largimi nga Reali

Keylor Navas, mesa duket, i ka orët e numëruara në Madrid. Transferimi i belgut Thibaut Courtois ka bërë që gardiani tjetër i "Los Blancos" të ulet në stol. Kjo situatë nuk është pëlqyer aspak nga ana e Navasit, i cili nuk e pranon rolin rezervë edhe për faktin se paraqitjet e tij me Realin në sezonet e kaluara kanë qenë pozitive. Gjithsesi është vetë numri një i stolit të "mbretërorëve", Santiago Solari, i cili i ka hapur derën e largimit portierit nga Costa Rika. Destinacionet janë të shumta, por më se shumti e ardhmja e Keilor Navasit është e lidhur me Premierë Ligë, që përkon edhe me vetë dëshirën e gardianit.

Ferrari dhe Mercedesi, rivalitet edhe për Mick Schumacherin

Botërori i Formulës 1 është mbyllur, por rivaliteti mes Ferrarit dhe Mercedesit po vijon. Në pistat e garave bilanci është dukshëm në favor të "Shigjetave të argjendta", Ferrari duket se ka fituar terren për sa i përket merkatos së pilotëve, pasi pritet që në të ardhmen të ketë në radhët e veta një pilot të ri, por me një mbiemër me peshë të madhe: Mick Schumacher. Suksesi i arritur këtë vit nga 19-vjeçari, djali i legjendës Michael Schumacher, që u shpall kampion evrope në Formula 3, e ka rritur shumë interesin te dy skuadrave më të rëndësishme të Formula 1. Në mbrëmjen Gala të FIA-s të ditëve të fundit, Toto Wolff e pranoi hapur dëshirën e tij për të parë Schumacher Jr. në radhët e Mercedesit, për të formuar një dyshe me Lewis Hamiltonin. Ndërsa gjatë muajve të verës ishte Maurizio Arrivabene ai që dha një mesazh të qartë, duke theksuar preferencën e Mick Schumacherit për Ferrarin. "Me mbiemrin që ka dhe që është pjesë e historisë së Ferrarit, është e qartë që dyert e Maranellos janë dhe do të jenë të hapura për Schumacherin, por nuk duhet t'i ushtrojmë presion", ishte deklarata e Arrivabenes. Për momentin, Mick Schumacher ende nuk ka firmosur kontratë me skuadrat e Formulës 1 por, sipas burimeve pranë familjes së tij, shumë shpejt 19-vjeçari do ta ndërmarrë këtë hap dhe duket se pajtimi do të jetë me Akademinë e Pilotëve të Ferrarit. Në vitin 2019 Mick Schumacher do të garojë në Botërorin e Formula 1 me skuadrën italiane Prema, me të cilën fitoi edhe titullin në F3. Rastësia do që kjo skuadër i shërbeu si trampolinë edhe Charles Leclerkit që në Botërorin e ardhshëm do të jetë piloti zyrtar i Ferrarit për të formuar skuadër me Sebastian Vettelin.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr. 3468/18 **Pejë, 14.12.2018**

Me bazë në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, UA nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës nr. 04/L-037, nenin 169, 170, 171, 172, 173, 174, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 04-V-622, Rregulloren për të Ardhurat Personale të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë ref. nr. 1944/16, e dt. 05.10.2016, Rregulloren për Procedurën Vlerësuese për Zgjedhjen dhe Avancimin e Personelit Akademik në UHZ, nr. 772, dt. 16.06.2014, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 11.12.2018, nxjerri vendim sipas të cilit:

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" në Pejë
shpall

KONKURS

për rizgjedhjen e personelit akademik të rregullt

I. Konkursi për shpalljen e pozitave në vijim:

FAKULTETI I BIZNESIT:

1. Një asistent për lëndët: Mikroekonomia, Makroekonomia, Bazat e marketingut;
2. Një asistent për lëndët: Financat e korporatave, Bazat e Ndërmarrësisë, Tregjet dhe institucionet Financiare, Kontabiliteti i institucioneve financiare;
3. Një asistent për lëndët: Bazat e kontabilitetit, Bazat e biznesit, Auditimi, Mjedisi i Biznesit.

Asistent në gjuhën boshnjake

1. Një asistent për lëndët: Mikroekonomija, Makroekonomija, Osnove menadzmenta, Menadzment MSP, Ekonomija EU i Kosova.

Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis:

1. Një aistent për Lëndët: Bazat e kontabilitetit (fakultetin e MTHM-së dhe Biznesit, dep. AB), Financat në turizëm, Analiza financiare në turizëm, Makroekonomia;
2. Një asistent për Lëndët: Marketingu i udhëtimeve turistike, Hyrje në statistikë, Hyrje në informatikë, Turizmi i qëndrueshëm, Turizmi ndërkombëtar;

Asistent në gjuhën boshnjake:

1. Një asistent për lëndët: Pravo u turizmu i ugostiteljstvu, Leadership, Mikroekonomija, Preduzetnistvo, Menadzment ljudskih resursa, Osnovi biznisa u turizmu i ugostiteljstvu, Uvod biznisa u turizmu i ugostiteljstvu.

II. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Rizgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim më Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, dispozitat e Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, si dhe Rregullores për Procedurën Vlerësuese për Zgjedhjen dhe Avancimin e Personelit Akademik Ref. Nr. 772 dt. 16.06.2014 në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
2. Kandidatët të cilët aplikojnë për rizgjedhje në pozitën e asistentit duhet të jenë të regjistruar në studimet e doktoratës, më saktësisht shih nenin 174, të statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

III. KUSHTET PËR APLIKIM:

1. Kandidatët të cilët aplikojnë për rizgjedhje në pozitën e asistentit duhet t'i paraqesin këto dokumente: kërkesën me biografi, kopjet e diplomave përkatëse të noterizuar, certifikatën e notave për nivelin bachelor dhe master, certifikatën e lindjes, vendimin e zgjedhjes së fundit, si dhe vendimin për regjistrimin e studimeve të doktoratës.
2. **Kandidatët që kanë mbaruar studimet bachlor ose master jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi nga MASHT përkatësisht vendimin për nostrifikimin e diplomës përkatëse, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.**
3. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes në web-faqen zyrtare të Universitetit dhe gazetë, respektivisht deri më 29.12.2018.
4. Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmive të nevojshme sipas konkursit, duhet fillimisht të dorëzohen në formë elektronike në e-mail: apliko.online@unhz.eu dhe pastaj në formë fizike në zyrën e protokollit në Rektorat nga ora 09:00-15:00. Aplikacionet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë:

http://www.unhz.eu

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Protokol. Br. 3468/18 **Peć , 14.12.2018**

Na osnovu člana 8. Zakona o radu br. 03 / L-212, UA br. 07/2017 o regulisanju konkursne procedure u javnom sektoru, član 26. Zakona o visokom obrazovanju na Kosovu, br. 04 / L-037, člana 169, 170, 171, 172, 173, 174, statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, br. 04-V-622, uredbe o ličnom dohotku Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći br. Pro. 1944/16, dt. 05.10.2016, Pravilnika o postupku procjene za izbor i napredovanje akademskog osoblja UHZ, br. 772, dt. 16.06.2014, Senat Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, na sjednici održanoj dana 11.12.2018, donio je odluku prema kojoj:

UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" Peć
objavljuje
K O N K U R S
za reizbor redovnog akademskog osoblja

I. Konkurs se objavljuje na sledećim pozicijama:

FAKULTET BIZNESA:
1. Jedan asistent za predmete : Mikroekonomija, Makroekonomija, Osnove marketinga;

2. Jedan asistent za predmete : Korporativne financije, Osnove poduzetništva, Finansijska tržišta i institucije, Računovodstvo financijskih institucija;

3. Jedan asistent za predmete: Osnove računovodstva, Osnove biznisa, Revizija, Okruženje biznisa .

Asistent na Bosanskom jeziku

1. Jedan asistent za predmete : Mikroekonomija, Makroekonomija, Osnove menadzmenta, Menadzment MSP, Ekonomija EU i Kosova.

FAKULTET ZA MENADŽMENT U TURIZMU, UGOSTITELJSTVU I OKOLIŠU

1. Jedan asistent za predmete: Osnove računovodstva (Fakultet MTHM i Biznisa, dep. AB), Financije u turizam, Financijske analize o turizmu,Makroekonomija;

2. Jedan asistent za predmete: Marketing turističkih putovanja, Uvod u statistiku, Uvod u informatiku, Održivi turizam, Međunarodni turizam;

Asistent na Bosanskom jeziku

1. Jedan asistent za predmete : Pravo u turizmu i ugostiteljstvu, Leadership, Mikroekonomija, Preduzetnistvo, Menadzment ljudskih resursa, Osnovi biznisa u turizmu i ugostiteljstvu, Uvod biznisa u turizmu i ugostiteljstvu.

II. OPŠTI USLOVI

1. Reizbor akademskog osoblja vrši se u skladu sa Zakonom br. 04 / L-037 o visokom obrazovanju u Republici Kosovo, u skladu sa dispozicijama Statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, Pravilnika za Procedure vrednovanja o reizboru i unapređivanje akademskog osoblja Pro. Br. 772 dt. 16.06.2014 na Univerzitetu "Haxhi Zeka" u Peći.

2. Kandidati koji apliciraju za reizbor na poziciji Asistenta trebaju biti upisani na doktorskim studijama , tačnije na osnovu člana 174 Statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći.

III. USLOVI ZA APLICIRANJE


1.Kandidati koji se prijavljuju za reizbor na poziciji Asistenta moraju dostaviti sljedeće dokumente: zahtjev sa biografijom, ovjerene kopije relevantnih diploma, uvjerenje ocjena za bachelor i master nivo, izvod rođenih, odluku o posljednjem izboru, kao i rešenje o upisu na doktorskim studijama.

2. Kandidati koji su završili bachelor ili master u inostranstvu ,moraju također priložiti dokaze iz MONT-a, naprotiv odluku o nostrifikaciji određene diplome, u suprotno, dosje od podnosioca će se smatrati nepotpunim.


3. Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja na službenoj web- stranici Univerziteta i novinama, tačnije do 29.12.2018.

4. Ispunjene aplikacije zajedno sa kopijama potrebnih dokaza na osnovu konkursa , trebaju se poslati u elektronskoj formi na e-mail:apliko.online@unhz.eu a onda i predati u kancelariji protokola u Rektoratu od 09:00-15:00 h.
Aplikacije poslane posle roka kao i one nekompletne neće se razmatrati.

Konkurs možete pronaći objavljen i na web stranici na adresi: http://www.unhz.eu







>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Urgjentisht kërkoj një lokal për blerje ne Prishtine. Lokali duhet te jete me dokumente ne rregull, çmimi deri 600.000 euro. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044741155.

▶ Daut Bale shpall te pavlefshme dëftesat e kl I , II Gymnazium Loyola Prizren.

▶ Bajram dullaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHF "Dëshmoret e Kabashit" Korishë.

▶ Omer Rama shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I , II SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

▶ NTP " FNW " shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit: 70214655 Prizren.

▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155\

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

▶ Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

▶ Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

▶ Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.



FITO 2 SUPER muaj FALAS me SuperDUO!

Abonohu në ndonjërën nga pakot **SuperDUO** dhe paguaj vetëm 10 muaj, ndërsa 2 të fundit merri **FALAS.** Përveç kësaj, fiton edhe **3 SIM kartela me 3 muaj komunikim FALAS** brenda rrjetit të IPKO-së. Pagesa mund të bëhet në baza mujore.

Pakot e **SuperDUO** janë pakot më të kompletuara në treg. Ato ofrojnë internet mbi **50Mbps** dhe përmbajtje mbi **150 kanale televizive** me të gjitha ligat më emocionuese të futbollit (Premier League, Serie A, La Liga), si dhe kanalet sportive më të popullarizuara botërore.

ÇKA O' SUPER O' SUPER!

Merr ofertën në dyqanin më të afërt të IPKO-së.

*Nxito, oferta është promocionale.

WWW.IPKO.COM

IPKO | DigitAlb